

Dokumenti i punës i profesionistëve të RAN P&P Qasjet ndaj autorëve të veprave të ekstremizmit të dhunshëm dhe lufta kundër radikalizimit në burgje dhe institucionet e shërbimit të provës

Hyrje

Ky dokument synon që t'i ofrojë politikëbërësve, drejtorëve të burgjeve dhe stafit të burgjeve dhe shërbimit të provës informacione për praktikën aktuale dhe çështjet që lidhen me menaxhimin e autorëve të veprave të ekstremizmit të dhunshëm (VEO) dhe individëve të konsideruar si të rrezikuar nga angazhimi në ekstremizmin e dhunshëm në kontekstin e burgjeve dhe institucioneve të shërbimit të provës¹. Dokumenti është strukturuar rreth këtyre dy konteksteve. Ndërkohë që ky dallim në praktikë mund të mos ekzistojë në disa shtete anëtare të BE-së, ai shërben për të identifikuar dy çështje kyçe: kushtet në burgje dhe strategjitë e riintegrit, vlerësimin e rrezikut, zgjedhjet e regjimit të burgjeve, nismat për rehabilitim dhe riintegrim dhe trajnimi i stafit.

Produkt i Qendrës së
Ekselencës së RAN
dhe Grupit të Punës
për Shërbimin e
Provës dhe Burgjet
(RAN P&P). Përgatitur
nga Ryan J. Williams,
bashkëpunëtor në
studim, Universiteti
i Kembrixhit, Qendra
e Studimeve Islamike
dhe Qendra e
Studimeve për Burgjet.

¹ Dokumenti i punës shtjellon më tej një dokument pune të mëparshëm me një titull tjetër. Rrjeti për Ndërgjegjësimin kundër Radikalizimit, 'Dealing with Radicalisation in a Prison and Probation Context Ran P&P - Practitioners Working Paper' (2015).



Ky dokument synon gjithashtu të ofrojë udhëzime dhe të ndihmojë në mbështetjen e proceseve vendimmarrëse, si në nivelin e politikave, edhe në nivelin e menaxhimit të burgjeve dhe shërbimeve të provës. Ndaj, gjatë përgatitjes së tij është dhënë rëndësi aksesueshmërisë më tepër se gjithëpërfshirjes. Nuk ekziston një zgjidhje unike, sepse shtetet anëtare të BE-së ndryshojnë në shumë aspekte, duke përfshirë legjislacionin dhe mënyrën së organizimit të sistemeve të burgjeve dhe shërbimit të provës². Megjithatë, bashkëpunimi ndërinstytucional është thelbësor në menaxhimin e rreziqeve që lidhen me radikalizmin dhe për të garantuar që VEO-ve t'u ofrohen mundësi për rehabilitim.

Që prej themelimit të Rrjetit për Ndërgjegjësimin kundër Radikalizmit (RAN) në vitin 2012, Grupi i Punës për Burgjet dhe Shërbimin e Provës (RAN P&P) është përqendruar në parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm, angazhimin në grupet ekstremiste dhe sjelljet ekstremiste gjatë periudhës së ndalimit dhe shërbimit të provës. Ky dokument bazohet në kontributet e ekspertëve dhe kërkimet e përditësuara mbi këtë temë, megjithëse kërkimet në këtë fushë mbeten të kufizuara për shkak të numrit relativisht të ulët të popullsisë së përfshirë. Grupi i punës RAN P&P përfshin 250 profesionistë, duke përfshirë përfaqësues nga shërbimet e provës, drejtues burgjesh, oficerë burgjesh, ministritë e drejtësisë dhe shërbimet e zbulimit, si dhe OJQ dhe organizata të shoqërisë civile që punojnë me autorët e veprave. RAN P&P ka organizuar 13 takime me profesionistë nga të gjitha shtetet anëtare të BE-së (duke përfshirë tre vizita studimore në burgje në tre vende të ndryshme) dhe kërkues lider duke mundësuar shkëmbime të cilësisë së lartë në një sërë temash³. Këto takime kanë theksuar një sërë praktikash premtuese në kontekstin e burgjeve dhe shërbimeve të provës, të cilat mund të gjenden në Tërësinë e Qasjeve dhe Praktikave të RAN⁴.

Profesionistët dhe politikëbërësit përballen me një presion të lartë politik dhe publik për të garantuar sigurinë publike. Pavarësisht këtyre presioneve, RAN P&P vazhdon të ruajë parimet udhëzuese të mëposhtme të cilat pasqyrohen në të gjithë dokumentin:

- siguria e shoqërisë garantohet më së miri duke promovuar mirëqenien dhe rehabilitimin e autorëve të veprave;
- krimet e terrorizmit përfshijnë një sërë veprimtarish; individët e dënuar për akte terroriste nuk përfaqësojnë të gjithë të njëjtin rrezik për shoqërinë;
- autorët veprave mund të arrijnë një ndryshim pozitiv dhe kanë nevojë për mbështetje për t'u shkëputur nga ekstremizmi i dhunshëm;
- të drejtat universale të njeriut duhet të respektohen gjatë gjithë kohës dhe në të gjitha rrethanat;
- nxitja e marrëdhënieve pozitive staf-i burgosur dhe klima e shëndetshme në burgje është një kusht paraprak për uljen e rrezikut për radikalizim dhe që kontribuon në rehabilitimin dhe riintegrimin e tyre;
- bashkëpunimi ndërinstytucional është thelbësor për të parandaluar radikalizimin dhe mbështetur proceset e shkëputjes nga krimi.

² "Handbook on the Management of Violent Extremist Prisoners and the Prevention of Radicalization to Violence in Prisons," Organizata e Kombeve të Bashkuara (Nju-Jork: Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogën dhe Krimin, tetor 2016). Forumi Global Kundër Terrorizmit, "Rome Memorandum on Good Practices for Rehabilitation and Reintegration of Violent Extremist Offenders," (Romë 2012).

³ Dokumentet përmbledhëse të këtyre ngjarjeve mund t'i gjeni në internet.

⁴ http://ec.europa.eu/dgs/home-affairs/what-we-do/networks/radicalisation_awareness_network/ran-best-practices/index_en.htm

Ky dokument pune trajton personat që janë dënuar ose janë në paraburgim për vepra që lidhen me terrorizmin dhe ata që konsiderohen në rrezik radikalizimi në kontekstin e burgjeve dhe shërbimit të provës.

Është bërë detyrë (dhe ndonjëherë kërkesë ligjore) që shtetet anëtare të parandalojnë aktet terroriste në institucionet publike si burgjet, dhe individët e rrezikuar nga radikalizimi përfshihen në këtë fushë. Në këtë raport theksojmë se këto lloje autorësh janë të ndryshëm dhe përfshijnë individë që nuk kanë kryer akte dhune dhe mund të mos kryejnë kurrë akte të tilla. Të qenit radikal nuk do të thotë se dikush do të kryejë më tej një veprim të dhunshëm. Ky ndryshim duhet të merret në konsideratë në çdo reagim ndaj radikalizimit. Ne gjithashtu pranojmë se menaxhimi efektiv i VEO-ve të dhunshme dhe atyre që konsiderohen si të rrezikuar nga radikalizimi kërkon një bashkëpunim ndërinstytucional. Është shumë e rëndësishme që autorët të marrin mbështetje të vazhdueshme dhe që informacioni të qarkullojë ndërmjet organizatave, duke përfshirë burgjet dhe shërbimet e provës, policinë dhe organizatat e komunitetit.

A e dinit se?

Autorët e veprave të ekstremizmit të dhunshëm - një rast i veçantë? Shtetet anëtare të BE-së aktualisht kanë një sërë opinionesh dhe qasjesh për VEO-të dhe çështjet që lidhen me radikalizimin. Disa i konsiderojnë normale rreziqet që shoqëron VEO-të (p.sh., Italia, nëpërmjet qasjes rehabilituese e cila nuk është përshtatur për VEO-të) dhe radikalizimin, ndërsa të tjerë i trajtojnë këto si rreziqe që kërkojnë struktura dhe/ose procese të veçanta (p.sh. Programi “Identiteti i shëndetshëm” në Mbretërinë e Bashkuar që ka si objektiv veçanërisht VEO-të)⁵.

- *Qasje të përgjithshme:* Ka një mbivendosje ndërmjet teorive të shkëputjes nga krimi dhe shkëputjes nga terrorizmi; është e rëndësishme që, së bashku me qasjet e specializuara, të ofrohet mbështetje profesionale dhe sociale sipas kërkesave⁶.
- *Qasje të specializuara:* Rrethanat individuale të autorëve të veprave mund të bëjnë që ata të kenë nevojë për qasje unike. Për shembull, individët që kanë ushtruar dhunë me motive ideologjike, kanë përjetuar traumë pasi kanë luftuar në një konflikt të huaj ose kanë zhvilluar aftësi të veçanta luftimi apo kanë lidhje me grupet ekstremiste, mund të kërkojnë ndërhyrje dhe procese të specializuara. Këto qasje të specializuara mund të kërkojnë ndërhyrje unike psikologjike dhe/ose me bazë fetare.

⁵ “Handbook on the Management of Violent Extremist Prisoners and the Prevention of Radicalization to Violence in Prisons.”, Organizata e Kombeve të Bashkuara

⁶ Adam Calverley, Cultures of Desistance: Rehabilitation, Reintegration and Ethnic Minorities (Taylor & Francis, 2012); Stephen Farrall, Understanding Desistance from Crime: Emerging Theoretical Directions in Resettlement and Rehabilitation, ed. Adam Calverley (Maidenhead: Open University Press, 2006).

Konteksti

Konteksti i terrorizmit ka ndryshuar në mënyrë dramatike për burgjet dhe shërbimet e provës. “Luftëtarët e huaj terroristë”⁷ tashmë zënë përqindjen më të lartë të arrestimeve dhe dënimeve në Evropë (Tabela 1). Numri i arrestimeve është trefishuar gjatë tre viteve të fundit, duke shtuar presionin mbi burgjet dhe shërbimet e provës ndërsa autorët e veprave lëvizin në sistemet e drejtësisë penale. Sipas Europol, terrorizmi i xhihadistëve dhe luftëtarëve të huaj përfaqëson përqindjen më të lartë të arrestimeve në BE gjatë tre viteve të fundit (Tabela 1).⁸

Llojet e tjera të terrorizmit, duke përfshirë terrorizmin etniko-nacionalist dhe separatist, dhe terrorizmin e majtë dhe anarkist, janë në rënie. Megjithatë, shqetësimet për ekstremizmin e djathtë janë shtuar ndërkohë që diskutet sociale dhe politike polarizuese dhe nativiste nxisin aktet e dhunës kundër myslimanëve dhe emigrantëve nëpërmjet lëvizjeve reaksionare, individëve ose grupeve të vogla. Këto tensione pritet që të vazhdojnë të rriten në të ardhmen e parashikueshme. Kjo klimë e ndërlikuar sociale dhe politike pasqyrohet edhe në burgje dhe i shtohet diversitetit të popullsisë dhe tensioneve që duhet të menaxhohen.

Tashmë, ka një sërë veprimtarish që konsiderohen vepra terroriste, shumica prej të cilave nuk janë të dhunshme dhe për pasojë përfaqësojnë një rrezik të kufizuar për shoqërinë. “Rreziqet më të ulëta” përfshijnë ato që shoqërojnë mbledhjen e fondeve, qëllimin për të udhëtuar ose mbajtjen e materialeve që konsiderohen si ekstremiste. Edhe karakteristikat e atyre që i kryejnë këto vepra penale kanë ndryshuar; popullsia është më e re, më e larmishme dhe përfshin më shumë gra. Profesionistët raportojnë se procesi i radikalizimit mund të jetë çuditërisht i shkurtër, deri në dy javë, dhe se rekrutimi mund të bëhet në burg.⁹

⁷ “Luftëtarët e huaj terroristë” përkufizohen nga Këshilli i Sigurimit i OKB-së (Rezoluta 2178) si “...shtetas që udhëtojnë ose përpiqen të udhëtojnë drejt një shteti [të ndryshëm nga territori ose shteti i tyre]... me qëllim kryerjen, planifikimin, përgatitjen ose pjesëmarrjen në akte terroriste, ose ofrimin apo marrjen e trajnimit terrorist në lidhje me një konflikt të armatosur”. Këtu përfshihen individët që largohen nga Evropa dhe udhëtojnë drejt Sirisë, Irakut, Malit ose Ukrainës.

⁸ “Raporti për situatën dhe trendin e terrorizmit në Bashkimin Evropian”, Europol, (Hagë: Bashkimi Evropian, 2016). f.18.

⁹ Megjithatë, studimet nuk kanë dokumentuar një proces të vetëm rekrutimi. Kombet e Bashkuara “Manuali për menaxhimin e të burgosurve ekstremistë të dhunshëm dhe parandalimin e radikalizimit të dhunës në burgje”, f. 114. Për diskutime mbi kompleksitetet e radikalizimit në burgje, shih «An Exploration of Staff-Prisoner Relationships at Hmp Whitemoor: 12 Years On», të Alison Liebling, Helen Arnold dhe Christina Straub, (Cambridge: Instituti i Kriminologjisë në Kembrixh, Qendra Kërkimore për Burgjet, 2011); «Social Relationships between Prisoners in a Maximum Security Prison Violence Faith and the Declining Nature of Trust», të Alison Liebling dhe Helen Arnold, Journal of Criminal Justice 40 (2012).

A e dinit se?

Terminologji e veçantë? Rënia dakord për terminologjinë është e dobishme për të përshkruar proceset dhe ndërhyrjet specifike. Në mënyrë të veçantë në një mjedis pune ndërinstitucional, një gjuhë e përbashkët mund të ndihmojë që palë të ndryshme të kuptojnë njëra-tjetrën dhe të bashkëpunojnë. Masa deri në të cilën kjo gjuhën përdoret edhe gjatë punës me vetë autorët e veprave duhet të shqyrtohet me kujdes.

- “Tërheqja” i referohet një ndryshimi në sjellje, si largimi nga një grup ose ndryshimi i rolit brenda këtij grupi.
- “Deradikalizimi” i referohet një ndryshimi konjitiv në të kuptuar dhe në pikëpamje që i largon individët nga legjitimimi i dhunës.¹⁰
- Në disa raste, përdorimi i (termit) “deradikalizim” mund të çojë në etiketim të papërshtatshëm dhe stigmatizim, i cili mund të jetë i dëmshëm.

Në rastin e disa VEO-ve që marrin dënime të shkurtra, sistemet e drejtësisë penale ka një hapësirë të kufizuar për të ndikuar në procesin e ndryshimit. Duke qenë se këto periudha për ndërhyrje janë të shkurtra, vazhdimësia ndërkohë që individit zhvendoset nga burgu në komunitet është thelbësore dhe duhet të përfshijë bashkëpunimin ndërinstitucional, sipas nevojave të vlerësuara, si dhe të ofrohet mbështetje. Duhet të shfrytëzohen mekanizmat e mbështetjes nga familja dhe bashkëpunimi me OJQ-të sektoriale të treta. Shërbimet e provës luajnë një rol të rëndësishëm në hartimin e këtyre alternativave të rehabilitimit në mjediset e burgut. Shifrat e luftëtarëve të huaj që priten të hyjnë në kontakt me sistemi gjyqësor ngrenë pikëpyetje për ndërhyrjet para procesit gjyqësor dhe gjatë vetë gjyqimit¹¹. Aktualisht, shtetet anëtare po kërkojnë mënyra për të parandaluar “dëmet gjatë mbajtjes në paraburgim” dhe në disa raste po vendosin në dispozicion opsione sanksionuese alternative për vepra më të lehta.

Tabela 1:

Viti	2013	2014	2015
Nr. i individëve të arrestuar në BE për vepra të lidhura me terrorizmin	537	774	1077
Nr. i individëve të arrestuar për terrorizëm xhihadist	216	395	687
Nr. i dënimeve të dhëna për vepra terroriste	258	345	417
Nr. i shfajësimeve për vepra terroriste	78	107	110

Burimi: Europol¹²

¹⁰ Shih https://ec.europa.eu/home-affairs/sites/homeaffairs/files/what-we-do/networks/radicalisation_awareness_network/about-ran/ran-exit/docs/ran_exit-ex_post_paper_london_15-16032016_en.pdf në internet.

¹¹ Forumi Global Kundër Terrorizmit “Rekomandimet për menaxhimin e burgjeve për të luftuar dhe trajtuar radikalizimin në burgje” (2015).

¹² “Raporti për situatën dhe tendencat e terrorizmit në Bashkimin Evropian (Te-Sat)”, Europol; “Raporti për situatën dhe tendencat e terrorizmit në Bashkimin Evropian (Te-Sat)”, (Hagë: Bashkimi Evropian, 2014); Europol “Raporti për situatën dhe tendencat e terrorizmit në Bashkimin Evropian (Te-Sat)”; Europol “Raporti për situatën dhe tendencat e terrorizmit në Bashkimin Evropian (Te-Sat)”.

Sfida që paraqesin VEO-të dhe radikalizimi nuk është e njëjtë në të gjitha shtetet anëtare të BE-së, por është e qartë se numri i VEO-ve po rritet me shpejtësi në të gjithë BE-në në tërësi, me 258 dënime për vepra terroriste në vitin 2013 dhe 417 në 2015 (Tabela 1). Franca (424), Spanja (187), Mbretëria e Bashkuar (134), dhe Belgjika (61) kanë raportuar numrin më të lartë të arrestimeve në vitin 2015.

Në shumë shtete anëtare të BE-së janë ekzistojnë tashmë procedura monitorimi (p.sh., Belgjikë, Francë, Itali, Holandë, Spanjë, Suedi, MB) për të menaxhuar rreziqet e lidhura me autorët e veprave, të cilët nuk janë dënuar për krime që lidhen me terrorizmin, por që rrezikojnë të kryejnë akte ekstremiste të dhunshme ose të shtyjnë të tjerët të bëjnë diçka të tillë. Të dhënat për numrin e individëve që po monitorohen për shkak të shqetësimeve në lidhje me ekstremizmin e dhunshëm jo gjithmonë raportohen nga shtetet anëtare dhe janë objekt i luhatjeve të shpeshtave. Sipas shifrave të disponueshme, në Angli dhe Uells janë duke u monitoruar 600 individë, ndërsa në Itali 124 individë që ndodhen në burg. Këto procedura monitorimi, megjithëse të kujdesshme, ngrenë pikëpyetje për çështje ligjore, të burimeve dhe etikës: si mund të monitorohet siç duhet një rrezik pa stigmatizuar individët si “ekstremistë” dhe pa kontribuar në largimin e tyre të mëtejshëm?

A e dinit se?

Ulja e rrezikut nëpërmjet mbështetjes: Burgjet dhe shërbimet e provës kanë si detyrë të kujdesen për individët nën kujdestarinë e tyre, duke përfshirë kujdesin për personat vulnerabël. Individët e dënuar për vepra ekstremiste dhe ata që konsiderohen se rrezikohen nga radikalizimi, në momente të rëndësishme, kanë nevojë për mbështetje. Menaxhimi i VEO-ve dhe personave që dyshohen se mund të radikalizohen për dhunë ose që mund të ndikojnë të tjerët për të pasur një mendësi ekstremiste të dhunshme nuk duhet të theksojë më tepër seç duhet rrezikun me qëllim që të përmbushë nevojat e individëve dhe të ofrojë mbështetje.

Rekomandime kyçe

- “Veprat terroriste” dhe individët që i kryejnë ato po rriten si spektër dhe jo të gjithë paraqesin të njëjtat rreziqe për shoqërinë. Reagimet duhet të jenë proporcionale; përndryshe ekziston rreziku i “dëmtimit gjatë mbajtjes në burg” për individët, rreziku i nxitjes së procesit të radikalizimit nëpërmjet masave joproporcionale.
- Të gjitha shtetet anëtare të BE-së kanë programe të përgjithshme rehabilitimi që synojnë lloje të ndryshme autorësh të veprave. Duhet të hulumtohet nëse VEO-të duhet të kenë qasje në programe të specializuara. Vendimet duhet të bazohen në rreziqet dhe nevojat individuale, këndvështrimi i politikave për trajtimin e VEO-ve, proporcionaliteti i hartimit të programeve të specializuara kundrejt madhësisë së grupit të synuar dhe rreziqet potenciale të stigmatizimit që kanë më shumë efekte të dëmshme se sa të dobishme.
- Nevojitet bashkëpunim ndër-institucional për të garantuar një vendimmarrje të informuar për ndërhyrjet (nëpërmjet shkëmbimit të informacioneve) dhe për të garantuar vazhdimësinë e ndërhyrjeve nga burgu në komunitet. Duhet të përfshihen të paktën përfaqësues nga burgu, shërbimi i provës, policia, organizatat komunitare, shërbimet sociale dhe shëndetësore dhe familja.

Konteksti i burgut

Mjedise të shëndetshme burgjesh

Studimi sugjeron se radikalizimi në mjedisin e burgut është i rrallë, por kushtet e burgut mund të luajnë një rol domethënës në rritjen ose uljen e rreziqeve¹³. Sulmet terroriste të kohëve të fundit në të gjithë Evropën janë kryer nga individë me të shkuar kriminale¹⁴. Mjedisi i burgut përfshin mjedisi fizik, si dhe vlerat, marrëdhëniet, procedurat dhe politikat që përbëjnë funksionimin e përditshëm të burgut. Këta faktorë formësojnë përvojën në burg dhe mund të paraqesin mundësi për të ulur rrezikun e radikalizimit gjatë qëndrimit në burg, si dhe rrezikun e përsëritjes së një veprë pas lirit në shoqëri.

Mbipopullimi, mungesa e stafit ose marrëdhëniet e dobëta ndërmjet stafit dhe të burgosurve dhe mjediset e varfra - duke përfshirë qasjen e dobët në veprimtari të dobishme si arsimi dhe puna - mund të kenë një ndikim negativ tek të burgosurit. Përforsimi i “sigurisë dinamike”¹⁵ është një qasje gjithëpërfshirëse për një mjedis të shëndetshëm në burg që përfshin dimensionet e mëposhtme¹⁶:

¹³ Mark S. Hamm, *The Spectacular Few: Prisoner Radicalization and the Evolving Terrorist Threat* (New York: New York University Press, 2013).

¹⁴ Simon Cottee, «Reborn into Terrorism: Why Are So Many Isis Recruits Ex-Cons and Converts,» *The Atlantic*, 25 Janar 2016.

¹⁵ Shih https://www.unodc.org/documents/justice-and-prison-reform/UNODC_Handbook_on_Dynamic_Security_and_Prison_Intelligence.pdf në internet.

¹⁶ Alison Liebling, *Prisons and Their Moral Performance* (Oxford: Oxford University Press, 2005).

Marrëdhëniet ndërmjet stafit dhe të burgosurve: Të burgosurit duhet të trajtohen me dinjitet, respekt dhe mirësjellje gjatë gjithë kohës. Marrëdhëniet e mira përfshijnë kujdesin për personat vulnerabël, si dhe ndihmën dhe mbështetjen. Marrëdhëniet efektive ndërmjet stafit dhe të burgosurve ndikojnë në mënyrë të konsiderueshme në sigurinë e stafit, të të burgosurve dhe publikut, duke lehtësuar qarkullimin e informacionit dhe duke përmirësuar cilësinë e tij. Marrëdhëniet e mira ndërmjet VEO-ve dhe stafit mund të ndihmojnë në krijimin e besimit dhe eliminimin e barrierave të tipit “ne kundër tyre”, të mosbesimit dhe dyshimeve ndaj autoriteteve, që shpesh vihen re mes njerëzve me mendësi ekstremiste. Ndaj investimi në ndërveprimin e përditshëm efektiv ndërmjet stafit dhe të burgosurve është një element kyç në trajtimin e VEO-ve.

Mirëqenia dhe zhvillimi personal: Mirëqenia dhe zhvillimi i autorëve duhet të përbëjnë bazat e rehabilitimit në burg. Garantimi i kësaj përfshin përmbushjen e nevojave bazë (qasjen në ushqim të mirë, mjediset sanitare të pastra, kohë në ajër të pastër) dhe ofrimin e trajnimeve profesionale në mënyrë që të burgosurit të zhvillohen në nivel personal. Qasja në arsim, në përpjekjet krijuese si arti dhe muzika dhe hapësira për praktikimin dhe ushtrimin e besimeve fetare janë të gjitha të rëndësishme për të nxitur zhvillimin personal dhe për të minimizuar mërzinë.

Kushtet dhe kontaktet me familjen: Kushtet në burg përfshijnë mjediset për mbajtjen e higjienës personale dhe dinjitetit, një hapësirë të pastër jetese dhe qasjen në dhe respektin për interesat kulturore dhe fetare nëpërmjet proceseve dhe mjediseve. Për shembull, kontrollet trupore dhe kontrollet e kryera me qen duhet të kryhen në një mënyrë që respekton normat kulturore dhe fetare. Kontakti me familjen është një formë kyçe e mbështetjes ndaj të burgosurve dhe kontribuon në marrëdhënie të shëndetshme pas lirimit. Shpeshtësia e kontaktit me familjen, një hapësirë e konsiderueshme për vizitat që përfshin hapësira të rehatshme për fëmijët dhe kohë të mjaftueshme për një kontakt domethënës janë të gjitha të rëndësishme për kontaktin me familjen. Lidhjet familjare janë të rëndësishme për riintegrimin e VEO-ve duke qenë se ata mund të shërbejnë (megjithëse, jo në të gjitha rastet) si një forcë shtytëse pozitive për rehabilitim.

Siguria dhe kontrolli: Një burg i organizuar, i kontrolluar dhe eficient i ofron të burgosurve një strukturë që përmbush pritshmëritë dhe u lejon atyre të ndihen të sigurt. Mungesa e një strukture dhe papajtueshmëritë në siguri dhe kontroll mund të kenë ndikime negative në përvojat e të burgosurve dhe ata mund t’i përmbushin nevojat për siguri në mënyra të tjera, duke përfshirë grupet (p.sh. grupet fetare, grupet kriminale) që ofrojnë mbrojtje. Këto grupe mund të rrisin dhe të formojnë hierarkinë mes të burgosurve (vendosjen e statusit) dhe konfliktet ndërmjet grupeve të të burgosurve, të rrisin rreziqet në burgje dhe të ulin perceptimet për sigurinë. Stafi i pamjaftueshëm ose personeli pa përvojë ndikojnë negativisht në sigurinë dhe kontrollin në burg.

A e dinit se?

Besimi i përshtatshëm nxit një kulturë sigurie dhe mbështetjeje ndërmjet stafit dhe të burgosurve: besimi i dhënë me zgjuarsi është thelbësor për sigurinë, kontrollin dhe vendosjen e një marrëdhënieje të mirë ndërmjet stafit dhe të burgosurve. Ai është gjithashtu thelbësor për rehabilitimin e të burgosurve. Mosbesimi ndaj individëve mund të dëmtojë vlerësimin që ata kanë për veten dhe mund të ndikojë negativisht në kapacitetin e autorëve për ta parë veten si të besueshëm dhe për t'u riintegruar në shoqëri. Një burg i drejtuar mirë duhet të bazohet në besimin e dhënë me zgjuarsi: besimi tek të burgosurit e besueshëm dhe ofrimi i mundësive për ata që konsiderohen si jo të besueshëm për të krijuar besim. Politikat e rënda ose ndëshkuese, si dhe marrëdhëniet e dobëta ndërmjet stafit dhe të burgosurve mund të rrezikojnë besimin, të kontribuojnë në largimin e tyre, të legjitimojnë pikëpamjet ekstremiste ndaj shtetit, të dëmtojnë përpjekjet për rehabilitim dhe të rrezikojnë sigurinë.

Profesionalizmi: Stafi profesionist i zbaton rregullat dhe i shpërndan privilegjet në mënyrë të drejtë dhe të barabartë. Ata gjithashtu i komunikojnë qartë rregullat dhe pritshmëritë në burg. Profesionistët duhet të tregojnë kujdes për t'u siguruar që praktikat ndëshkuese të zbatohen vetëm kur janë shteruar të gjitha opsionet e tjera. Stafi duhet të komunikojë qartë me të burgosurit në mënyrë që ata të kuptojnë se pse kundrejt tyre po ndërmerren veprime të caktuara disiplinore dhe të dinë se çfarë sjelljesh duhet të ndryshojnë. Profesionalizmi përfshin trajtimin e barabartë të VEO-ve dhe autorëve të tjerë. Profesionalizmi mund të vihet në provë nga autorët. VEO-të me një përkatësi të fortë ideologjike dhe me probleme besimi ndaj autoriteteve mund të vënë në provë stafin duke i nxjerrë ata "jashtë natyrës njerëzore" (p.sh., duke i quajtur qen) dhe duke shënjestruar pikëpamjet dhe mendimet e tyre personale. Anëtarët e stafit të burgut duhet të jenë të trajnuar dhe të marrin mbështetje që të mund ta dallojnë një sjellje të tillë dhe të dinë se si t'i përgjigjen në mënyrë profesionale.

A e dinit se?

Profesionalizmi kërkon drejtësi (legjitimitet): drejtësia përfshin procese të drejta dhe rezultate të drejta. Proceset e drejta përfshijnë procedura vendimmarrëse cilësore dhe drejtësi në mënyrën se si njerëzit trajtohen personalisht nga stafi i burgut dhe shërbimeve të provës. Rezultatet e drejta nënkuptojnë trajtimin në mënyrë të barabartë dhe të drejtë të grupeve të veçanta. Favorizimi ose mosmbështetja e një grupi mund të ulë legjitimitetin e burgut. Veçimi i një grupi, si për shembull autorët e veprave myslimanë ose autorët e veprave të terrorizmit, mund të përforcojë ndasitë "ne" kundër "atyre" (p.sh., "shteti është kundër myslimanëve") dhe të vërë në pikëpyetje legjitimitetin e burgut dhe të shtetit, duke përforcuar ideologjinë ekstremiste.

Është e rëndësishme që të merret në konsideratë fakti se grupe të ndryshme etnike dhe fetare kanë përvoja të ndryshme (p.sh., në lidhje me diskriminimin, marginalizimin, islamofobinë ose racizmin) dhe se njohja e barazisë dhe diversitetit shmang përforcimin e këtyre përvojave dhe

dëmtimin. Studimet kanë treguar se si një mjedis jo i shëndetshëm në burg mund të krijojë kushtet që kontribuojnë në radikalizim dhe mund të kontribuojë dhe më gjerë në rezultate negative për të gjithë autorët e veprave¹⁷, duke përfshirë nivele të rritura stresi që çojnë në vetëvrasje¹⁸.

A e dinit se?

Të burgosurit “e vështirë” dhe mjedisi i burgut: sjellja problematike e të burgosurit mund të lidhet me mjedisin e burgut. Trajtimi i padrejtë, regjimet me organizim të dobët ose acarimet që lidhen me kontaktet me familjen janë të gjitha rrethana që mund të ndikojnë në sjelljen e një të burgosuri. Studimet kanë treguar se të burgosurit e vështirë mund të jenë të vështirë në disa mjedise, por jo në disa të tjera¹⁹, duke sugjeruar se sjellja sfiduese, duke përfshirë atë që lidhet me radikalizimin, duhet të shqyrtohet në lidhje me regjimin e burgut.

Rekomandime kyçe

- Një mjedis i shëndetshëm burgu është faktori parësor ndalues për radikalizimin. Rreziqet e radikalizimit ulen në kushtet e një burgu profesionist, të sigurt dhe të drejtë. Mungesa e këtyre elementeve mund të përforcojë mendësitë ekstremiste dhe mosbesimin ndaj autoriteteve dhe mund të rrisë formimin e grupeve dhe të nxisë dhunën.
- Investimi në marrëdhëniet e përditshme ndërmjet stafit dhe autorëve të veprave, nëpërmjet fuqizimit të stafit, profesionalizmit, respektit dhe masave dinamike të sigurisë, janë elementet kyçe në punën me VEO-të.

Vlerësimi i rrezikut dhe mbështetja

Aktualisht, ndërmjet shteteve anëtare të BE-së ka papajtueshmëri për mënyrën se si i përdorin rezultatet e informacioneve nga zbulimi dhe vlerësimi i rrezikut dhe mënyrën se si i mbledhin informacionet. Qasjet variojnë nga gjykimi profesionist te instrumentet për vlerësimin formal të rrezikut.

Aktualisht, vlerësimi i rrezikut bëhet në dy forma:

- mbledhja, monitorimi dhe analizimi i informacionit;
- përdorimi i instrumenteve specifike të vlerësimit të rrezikut për VEO-të dhe ata që dyshohen si të radikalizuar ose që ndikojnë të tjerët.

Shtetet anëtare nxiten që të ndjekin parimet udhëzuese të paraqitura në faqen 1.

¹⁷ Hamm, *The Spectacular Few: Prisoner Radicalization and the Evolving Terrorist Threat*.

¹⁸ Alison Liebling, *Suicides in Prison* (London: Routledge, 2002).

¹⁹ Roy D. King and Kathleen McDermott, “‘My Geranium Is Subversive’: Some Notes on the Management of Trouble in Prisons,” *The British Journal of Sociology* 41, no. 4 (1990).

A e dinit se?

Çfarë është sjellja armiqësore? në përpjekje për të parandaluar aktet e dhunshme ekstremiste më shumë vëmendje i është dhënë identifikimit të sjelljeve ekstremiste jo të dhunshme që mund të jenë paralajmëruese të dhunës brenda ose jashtë burgut. Kjo ka çuar në probleme të konsiderueshme për stafin që ka si detyrë të identifikojë sjelljet shqetësuese. Dallimi i rrezeve që lidhen me radikalizimin është i vështirë edhe në mjediset e burgjeve. Vija dalluese midis “sjellje burgu” (rezistencë, luftë për pushtet ose anëtarësim në një grup për mbrojtje) dhe “sjellje ekstremiste” (kryerja e akteve të dhunshme) shpesh nuk është e qartë. Vlerësimi i strukturuar individual dhe stafi i trajnuar mund të ndihmojnë në vlerësimin më të saktë të rrezikut, motivimit dhe nevojave të të burgosurve.

Disa shtete anëtare kanë tashmë procedura (p.sh., Belgjika, Franca, Italia, Holanda, Spanja, Suedia, Mbretëria e Bashkuar) për zbulimin e radikalizimit. Këto procedura përfshijnë mbledhjen e informacioneve të inteligjencës dhe raportimin²⁰. Informacionet e inteligjencës janë thelbësore për një funksionim pa probleme të burgjeve, por monitorimi i ekstremizmit i nënshtrohet një pozitivizmi të rremë. Ndaj, ne rekomandojmë katër grupe konsideratash për të ndihmuar vendimmarrjen e lidhur me informacionet e inteligjencës:

1. nëse informacionet e inteligjencës përdoren për të informuar vendimmarrjen, përfshirë vendosjen e të burgosurve në njësi të veçanta, ato duhet të përdoren në respekt të kuadrove ligjore dhe të drejtave të njeriut;
2. sistemet e inteligjencës për “grupin e synuar” duhet të shtrihen në disa nivele: ato duhet të njohin shkallët dhe nivelet e rrezikut ose kërcënimit (p.sh., në lidhje me kapacitetin, qëllimin dhe angazhimin) dhe duhet të specifikojnë nëse ky kërcënim lidhet me vetë autorin e veprës, me oficerët e burgut, të burgosurit e tjerë ose publikun;
3. informacionet e inteligjencës duhet të përdoren në mënyrë dinamike, duke u lejuar individëve që të ulin rreziqet e tyre dhe informacioni i inteligjencës të mos merret në konsideratë nëse është i pavlefshëm ose i vjetruar;
4. informacioni i inteligjencës duhet të jetë i kontekstualizuar: individët që shfaqin shqetësime dhe informacionet e inteligjencës për radikalizim duhet ta vendosin këtë informacion në kontekstin përkatës dhe ta lidhin me burime të tjera informacioni. Ky kontekstualizim duhet të përfshijë:
 - raporte nga persona me njohuri personale ose të ngushta për autorin e veprës, të cilët mund të japin kontekstin dhe botëkuptimin e tij, për shembull, një kapelan ose oficer burgu;
 - të dhëna aktuariale për individin dhe veprën;
 - faktorë dinamikë: si punësimi, strehimi, shëndeti mendor, mbështetja familjare etj.; ndryshimet e këtyre faktorëve në veçanti mund të çojnë në rritjen e rrezikut, ose situatat zbutëse që mund të ulin rrezikun;

²⁰ Forumi Global Kundër Terrorizmit “Rekomandimet për menaxhimin e burgjeve për të luftuar dhe trajtuar radikalizimin në burgje”.

- faktorë klinikë: gjykimi dhe përvoja profesionale, përdorimi i përvojës personale dhe profesionale për të vlerësuar informacionin e mbledhur nëpërmjet intervistave dhe leximit të dosjeve;
- informacion nga partnerët në kuadrin ndërinstitucional si nga punonjësit socialë, policia, shërbimet e inteligjencës, për një individ.

Disa shtete anëtare (p.sh., Suedia) kanë një shërbim të posaçëm inteligjence për burgjet. Një ankesë e dëgjuar shpesh nga drejtorët e burgjeve është mungesa e shkëmbimit të informacionit ndërmjet burgjeve dhe shërbimeve të inteligjencës. Disponimi i një shërbimi të posaçëm inteligjence për burgjet mund të mundësojë protokolle për shkëmbimin e informacionit që mund t'ia bënin më të lehtë shërbimeve të inteligjencës që të informonin burgjet për autorët e veprave që mund të kenë nisur një proces radikalizimi.

A e dinit se?

Radikalizimi dhe sjellja fetare: për ekstremizmin e frymëzuar nga feja është shumë e rëndësishme që të mos ngatërrohen njerëzit që mund të kenë (ri)zbuluar besimin e tyre me njerëzit që kanë zhvilluar pikëpamje radikale. Shumica e personave që konvertohen ose kthehen pranë fesë, p.sh. në islam, gjatë burgosjes, e bëjnë diçka të tillë për motive paqësore individuale ose për t'u lidhur me një grup të burgosurish të tjerë. Paragjykimet për lidhjet ndërmjet fesë dhe ekstremizmit mbeten ende të pranishme dhe mund të pengojnë vlerësimin e saktë të rrezikut. Trajnimi i stafit për diversitetin dhe ndërgjegjësimin ndihmon në shmangien e ngatërimit të këtyre dy kategorive.

Një sërë shtetesh anëtare aktualisht përdorin disa instrumente formale për vlerësimin e rrezikut që besohet se shoqëron njerëzit e dyshuar ose të dënuar për ekstremizëm të dhunshëm²¹. Megjithatë, vlerësimi i rrezikut për radikalizim është aktualisht në hapat e para. Një vlerësim i saktë duhet të marrë në konsideratë gamën e motivimeve dhe rrethanave që kontribuojnë në radikalizim, të cilat ndryshojnë për autorë të ndryshëm dhe mund të përfshijnë nevojat ekzistencialiste të përkatësisë, angazhimet ideologjike, stimujt financiarë ose glorifikimin e dhunës²². Duke qenë se këto vlerësime të rrezikut fokusohen në ekstremizmin e dhunshëm, ato janë hartuar për t'u zbatuar së bashku me vlerësimet e përgjithshme të rrezikut dhe instrumente të tjera që përdoren për të vlerësuar rreziqet dhe nevojat e përgjithshme të autorëve të veprave.

Vlerësimet janë të kufizuara në vlerë nëse nuk kryhen shpesh. Ato duhet të trajtohen si një veprimtari e vazhdueshme, e koordinuar me gjykimet profesionale. Instrumentet e vlerësimit të rrezikut mund

²¹ Këtu përfshihet instrumenti Vera 2, REM (Vlerësimi i rrezikut në menaxhimin e ekstremizmit) dhe ERG22+ (Udhëzues për rrezikun e ekstremizmit). Shih D. Elaine Pressman and John Flockton, 'Violent Extremist Risk Assessment: Issues and Applications of Teh Vera-2 in High-Security Correctional Setting', in *Prisons, Terrorism and Extremism: Critical Issues in Management, Radicalisation and Reform*, ed. Andrew Silke (London: Routledge, 2014). RAN P&P Visit Penitentiary Institute, Vught 26 November 2015. Monica Lloyd and Chris Dean, 'The Development of Structured Guidelines for Assessing Risk in Extremist Offenders', *Journal of Threat Assessment and Management* 2, no. 1 (2015).

²² "Manuali për menaxhimin e të burgosurve për vepra të ekstremizmit të dhunshëm dhe parandalimin e radikalizimit të dhunës në burgje" i Kombeve të Bashkuara, f. 42

të përdoren për një sërë arsyes, duke përfshirë vlerësimin e nevojave të autorit të veprës dhe sigurimin e informacioneve për vendosjen e përshtatshme të tij, programet dhe mbështetjen.

A e dinit se?

Influencat radikalizuese: përcaktimi nëse dikush po përpiqet të influencojë një person tjetër që të përvetësojë sjellje të dhunshme ekstremiste është një sfidë madhore në kontekstin e shqetësimeve aktuale. Influencimi i të tjerëve supozon qëllimin për të nxitur të tjerët drejt dhunës dhe supozon se dikush është i gatshëm të marrë një qëndrim dhe sjellje të dhunshme. Praktikrat e menaxhimit të rrezikut duhet të bëjnë kujdes për të ndarë rreziqet nga individët që shtynë të tjerët të marrin qëndrime ekstremiste nga format e tjera të ndërveprimeve sociale. Grupet me bashkëvuajtësit e dënimit në burgje mund të ofrojnë mundësi për udhëheqje prosociale. Praktika e menaxhimit të rrezikut duhet të tregojë gjithashtu kujdes për individët vulnerabël që mund të jenë subjekt i bulizmit dhe sjelljeve imponuese.

Instrumentet e vlerësimit të rrezikut nuk duhet të përdoren si instrumente parashikuese për të matur kërcënimin ose sjelljen e një individi në të ardhmen. Përdorimi i këtyre instrumenteve mund të ketë disa efekte të dëmshme, duke përfshirë etiketimin e individëve si “ekstremistë”, duke kontribuar kështu në largimin e tyre dhe ndoshta edhe duke ulur legjitimitetin (drejtësinë) e burgut²³. Ndaj, është e rëndësishme që të vlerësohet plotësisht dhe vazhdimisht çdo individ, duke i kushtuar vëmendje rrethanave të tyre personale, sociale dhe mjedisore²⁴. Theksi mbi vlerësimin dhe zbulimin e rrezikut nuk duhet të cenohet mundësitë e autorëve të veprave për siguri, zhvillim personal ose kontakte me familjen.

Me qëllim njohjen e ndryshimeve pozitive dhe negative, është e rëndësishme që vlerësimet të përsëriten në intervale të rregullta ose gjatë kohës së ndryshimeve. Kjo është thelbësore për të dokumentuar dhe kuptuar uljet e nivelit të rrezikut që një autor i caktuar mund të tregojë gjatë evoluimit të procesit të tij të shkëputjes dhe për transparencën në vendimmarrje në lidhje me, për shembull, programet dhe vendosjen e të burgosurve.

²³ Alison Liebling and Ryan J. Williams, ‘The New Subversive Geranium: Some Notes on the Management of Additional Troubles in Maximum Security Prisons’, *British Journal of Sociology* (in press).

²⁴ ‘Handbook on the Management of Violent Extremist Prisoners and the Prevention of Radicalization to Violence in Prisons’, i Kombeve të Bashkuara, f. 42.

²⁵ Alison Liebling et al., ‘Locating Trust in a Climate of Fear: Religion, Moral Status, Prisoner Leadership, and Risk in Maximum Security Prisons — Key Findings from an Innovative Study’, (Prisons Research Centre, Institute of Criminology: University of Cambridge, 2015).

A e dinit se?

Lidershipi karizmatik: niveli i prestigjit social që gëzojnë të burgosurit mund të përcaktohet nga një sërë faktorësh. Studimet kanë treguar se statusi i një të burgosuri krijohet nga informacionet që importohen në burg (hierarkitë e krimeve) dhe ato çfarë konsiderohen si të vlefshme në kontekstin e burgut për të pakësuar dhimbjet që shoqërojnë burgosjen (p.sh., lidhjet sociale). Lidershipi ndërmjet të burgosurve duhet të kuptohet në kontekstin më të gjerë social, material dhe moral të burgjeve. Studimet e fundit kanë zbuluar prova për hierarkitë e të burgosurve që krijohen në një mjedis burgu të tensionuar, me marrëdhënie të dobëta ndërmjet stafit dhe të burgosurve, dhe për rastet kur liderët sjellin një ekuilibër, stabilitet dhe rregull në grupin të cilit i përkasin.²⁵


Rekomandime kyçe

- Instrumentet e monitorimit dhe shkëmbimit të informacioneve të inteligjencës për radikalizimin dhe rekrutimin nevojiten për të vlerësuar nivelin e rrezikut dhe kërcënimit të VEO-ve (për ata vetë, autorët e tjerë, stafin dhe publikun); organizimi i diçkaje të tillë brenda sistemit të burgjeve mund të rrisë bashkëpunimin me policinë dhe shërbimet e përgjithshme të inteligjencës;
- Për ekstremistët e dhunshëm nevojiten instrumente të specializuara për vlerësimin e rrezikut; informacioni duhet të mblidhet nga shumë burime dhe duhet të tregohet kujdes për të reduktuar anshmërinë e vlerësuesit;
- Instrumentet e specializuara të vlerësimit të rrezikut duhet të plotësojnë instrumentet dhe qasjet e tjera të vlerësimit të rrezikut dhe nevojave;
- Vlerësimet e rrezikut duhet të kryhen rregullisht, në mënyrë që ndryshimet në nivelet e rrezikut të tregohen qartë; vlerësimi duhet të marrë në konsideratë rrethanat personale, sociale dhe mjedisore të autorit të veprës;
- Protokollet e vlerësimit të rrezikut duhet të përshtaten sipas kompleksitetit/madhësisë së procesit/popullatës, nivelit të burimeve dhe kapaciteteve të stafit në një shtet anëtar;
- Për sa i përket rehabilitimit, vlerësimi i rrezikut duhet të përfshijë një vlerësim të nevojave - të përgjithshëm dhe specifik për të trajtuar një mendësi ekstremiste (p.sh., më shumë kontakte me familjen, zhvillimi i të kuptuarit fetar, më shumë kontakte me të burgosurit e tjerë ose anëtarë të stafit që mund të kenë ndikim pozitiv te një VEO).

Zgjedhjet në regjimin e burgjeve: përqendrimi, shpërndarja ose një kombinim i tyre

Shtetet anëtare të BE-së aktualisht përdorin një prej tre llojeve të regjimeve për të menaxhuar VEO-të dhe individët e konsideruar ose si në rrezik radikalizimi, ose si influencues të tjerëve²⁶. Jo të gjithë VEO-të ndodhen në burgje të sigurisë së lartë (disa vende nuk kanë burgje të sigurisë së lartë) dhe disa shtete anëtare kanë burgje të posaçme për VEO-të e akuzuar ose dënuar për krime terroriste (p.sh., Belgjika, Franca, Italia, Holanda, Spanja). Politikat dhe praktikat në këtë fushë po ndryshojnë me shpejtësi, ku disa vende po eksplorojnë zgjedhje të ndryshme për regjimin (Anglia dhe Uells, për shembull, po mendojnë që të kalojnë nga një model shpërndarjeje në një njësi të veçantë, ndërsa Franca ka eksperimentuar me njësitë e veçanta në vitin 2016). Në këtë seksion shikohen ndryshimet ndërmjet regjimeve të burgut sipas modeleve të përqendrimit, shpërndarjes ose kombinimit, si dhe sfidat dhe përfitimet e secilit prej tyre. Në figurën 1 jepen detaje të një pjese të procesit të vendimmarrjes që përfshin këto zgjedhje të regjimeve.

Figura 1: Grafiku i vendimmarrjes për tre modelet e burgosjes së VEO-ve dhe autorëve të veprave të radikalizuara



²⁶ Roy D. King and Kandra L. Resodihardjo, 'To Max or Not to Max', *Punishment & Society* 12, no. 1 (2010).

Modeli i kufizimit: VEO-të dhe njerëzit e dyshuar për radikalizim vendosen në njësi të ndara - ndonjëherë këto njësi më të vogla ndjekin një regjim të ngjashëm, ndonjëherë ato kanë regjime unike që ndihmojnë stafin të menaxhojë rreziqe dhe sjellje specifike (shih konsiderimet për njësitë e veçanta). Modelet e kufizimit mund “t’i mbledhin” VEO-të dhe të dyshuarit së bashku, ose ato mund të shërbejnë si njësi të veçanta për lloje të ndryshme individësh me sjellje problematike (d.m.th. jo vetëm VEO). Modeli i kufizimit është fillimisht një mundësi për VEO-të që futen në sistemin e burgjeve, por është edhe një opsion për individët që nuk janë dënuar për veprën e terrorizmit të dhunshëm, nëse sjellja e tyre lidhet me radikalizimin (shih “kriteret e hyrjes”, f. 13).

A e dinit se?

“Kriteret e hyrjes” për njësitë e veçanta: Për t’u bërë pjesë e njësive të veçanta duhet të përmbushen kriteret. Kriteret duhet të përfshijnë: bazën mbi të cilën merren vendimet për të zhvendosur një individ drejt një njësie speciale; kriteret e sakta të përdorura; mënyrat në të cilat sjelljet problematike që shoqërojnë radikalizimin janë të ngjashme me ose të ndryshme nga sjelljet e tjera problematike që vihen re në mjedisin e burgut; transparencën e vendimeve; nëse ato i nënshtrohen ose jo një kontrolli ligjor; dhe nëse vendimet janë në pajtim me të drejtat e njeriut.

Avantazhet: kufizimi lejon monitorimin nga afër të sjelljeve dhe ndërveprimeve. Nëpërmjet trajnimit, stafi mund të bëhet shumë i specializuar për të punuar me këtë popullatë dhe ndërhyrjet mund të përqendrohen në nevojat e tyre. VEO-të ndahen nga popullata e përgjithshme dhe kjo shmang ndryshimet në hierarkinë e pushtetit dhe ushtrimin e influencës nga ana e VEO-ve në ekstremizmin e dhunshëm. Modeli i kufizimit garanton gjithashtu që VEO-të dhe ata që konsiderohen si rrezik për radikalizimin e të tjerëve të mos rekrutojnë drejtpërsëdrejti ose nuk ndikojnë drejtpërsëdrejti tek individët e tjerë të popullatës së përgjithshme. Gjithashtu, për publikun kjo është një mënyrë shumë “e dukshme” për të trajtuar VEO-të.

Disavantazhet: vendosja e VEO-ve së bashku mund të forcojë lidhjet sociale dhe të kontribuojë në një kulturë kundërshtimi ndërmjet të burgosurve dhe stafit, duke dëmtuar përpjekjet e stafit për të ndërtuar marrëdhënie të mira dhe besim. Këto dinamika sociale mund të krijojnë një mendësi kundërshtuese ndërmjet “neve” dhe “atyre” dhe të përforcojë pikëpamjet se shteti është kundër individëve. Grupimi sipas përkatësive të ngjashme fetare ose etnike gjithashtu mund të përforcojë pikëpamjet që ekzistojnë brenda burgut, ose më gjerë, brenda shoqërisë për trajtimin e padrejtë të disa grupeve të caktuara fetare ose etnike, duke legjitimizuar ankesat. Njësit mund të jenë një burim stigme dhe statusi (shih “njësitë e veçanta” në vijim), duke përmbushur qëllimet e tyre duke dëmtuar “imazhin” që autorët e veprave kanë për veten ose duke i kthyer njësitë në vende të lakmuara; në të dyja rastet, kjo dëmton përpjekjet për rehabilitim. Qasja i trajton të gjithë autorët e veprave të ekstremizmit si të barabartë për nivelin dhe shkallën e rrezikut, pavarësisht një sërë veprimtarish që përfshin emërtimi “vepra të ekstremizmit të dhunshëm”, duke përfshirë ato që lidhen me grumbullimin e fondeve, udhëtimin dhe dhunën. Kostot e mjediseve dhe regjimeve të ndërtuara për këtë qëllim janë të larta dhe ka pak studime për të përcaktuar se sa

mirë funksionojnë këto njësi. Përvojat (e hershme) me njësitë e veçanta, për shembull në Holandë dhe Francë, tregojnë vështirësi në gjetjen e një stafi të mirë. Kur ndodhin incidente (p.sh. kur plagoset një anëtar i stafit), pozicionet e punës në këta sektorë të veçantë bëhen shumë më pak tërheqëse. Gama e veprave të terrorizmit është në rritje, ashtu si edhe larmia e rreziqeve dhe nevojave të autorëve të veprave (meshkuj/femra, vepra të ndryshme, prejardhje të ndryshme ideologjike) brenda sektorit të veçantë. Vendosja e një regjimi të vetëm sigurie që funksionon pavarësisht këtyre ndryshimeve ka rezultuar të jetë e vështirë.

A e dinit se?

Sfida e “njësive të veçanta”: Vendosja e VEO-ve dhe personave të tjerë që rrezikojnë të radikalizojnë të tjerët në njësi të veçanta nxjerr probleme që lidhen me stigmatizimin dhe statusin. Njësitë e veçanta rrezikojnë që të vendosin etiketime të rrezikut për këta individë, gjë që pengon mundësitë për rehabilitim. Ato gjithashtu mund të kontribuojnë në lidhjet në grupe ndërmjet të burgosurve dhe të dëmtojnë përpjekjet për rehabilitim. Njësitë e veçanta mund të shërbejnë si burim

statusi, sikur dërgimi në një njësi të veçantë e dallon të burgosurin nga të tjerët dhe mund të shikohet si shenjë prestigji. Rastet për përdorimin e njësive të veçanta në vend të proceseve dhe strukturave ekzistuese për menaxhimin e sjelljes problematike duhet të artikulohet qartë në çdo kontekst.

Modeli i shpërndarjes: VEO-të dhe personat e dyshuar për radikalizim vendosen në popullatën e përgjithshme të burgut dhe përfshihen në të njëjtin regjim të përgjithshëm. Sipas kësaj qasjeje, bëhet asnjë përpjekje për të normalizuar VEO-të brenda popullatës së përgjithshme - megjithëse regjimet e sigurisë për këta autorë veprash mund të jenë të ndryshme. Sjelljet problematike të VEO-ve dhe të burgosurve të tjerë në lidhje me radikalizimin mund të menaxhohen nëpërmjet procedurave ekzistuese. Për të burgosurit problematikë mund të kërkohet një vendosje e veçantë në përputhje me procedurat e burgut.

Avantazhet: meqenëse të burgosurit vendosen bashkë me popullatën e përgjithshme të të burgosurve, ato nuk i nënshtrohen të njëjtave burime të stigmës ose marginalizimit, të cilat pasojnë vendosjen në një njësi të veçantë. Gjithashtu, nuk lindin problemet që lidhen me statusin që krijohet nga vendosja në një njësi të veçantë. VEO-të mund të kenë mundësi të ndryshojnë qëndrimet dhe sjelljen e tyre nëpërmjet ndërveprimeve me popullatën e përgjithshme të të burgosurve. Kostot financiare të kësaj qasjeje mund të jenë më të ulëta krahasuar me njësitë e veçanta.

Disavantazhet: nuk punësohet një staf i specializuar dhe stafi i përgjithshëm mund të mos jetë i trajnuar për të kuptuar plotësisht këtë popullatë ose shenjat e rrezikut. Rreziqet e ekstremizmit janë më të vështira për t'u identifikuar tek të burgosurit e përgjithshëm, duke qenë se këto rreziqe janë pjesë të një subjekti që zotëron dinamika të tjera sociale dhe rreziqe të tjera ndaj rregullit dhe kontrollit. Ka gjithashtu shqetësime se shpërndarja e VEO-ve në popullatën e përgjithshme rrit mundësitë për radikalizim të të tjerëve dhe ofron mundësi për ndërthurjen e kulturave të krimit.

A e dinit se?

“Kriteret e daljes” nga njësitë e veçanta: duhet të ketë kriteret të qarta për nxjerrjen e njerëzve nga njësitë e veçanta. Konsideratat kryesore përfshijnë: Nëse njësitë e veçanta përdoren për të burgosurit problematikë dhe VEO-të, çfarë merret në konsideratë që autorët e veprave të nxirren nga këto njësi? A janë specifikuar “kriteret e daljes” apo përdoren njësitë speciale për të gjithë kohëzgjatjen e dënimeve të autorëve të veprave? Të burgosurve duhet t’i jepen mundësi për të modifikuar sjelljen e tyre dhe që këto ndryshime t’u njihen.

Modeli i kombinimit: Personat e dyshuar ose të dënuar për akte ekstremiste të dhunshme vendosen ose në një regjim të veçantë, ose në një regjim të zakonshëm, në varësi të vlerësimit të rrezikut dhe sjelljes së të burgosurit.

Avantazhet: Modeli i kombinimit ofron fleksibilitet dhe përshtatshmëri sipas rreziqeve dhe nevojave të individëve.

Disavantazhet: Kriteret dhe instrumentet e vlerësimit të rrezikut për të përcaktuar vendosjen e përshtatshme nuk janë të sakta (shih Vlerësimi i rrezikut dhe mbështetja). Modeli i kombinimit ka kosto duke qenë se nevojiten trajnim për stafin dhe burime të specializuara.

Tabela 2: Përmbledhje e avantazheve dhe disavantazheve të mundshme të zgjedhjes së regjimit

Zgjedhja e regjimit	Avantazhet e mundshme	Disavantazhet e mundshme
Kufizimi	<ul style="list-style-type: none"> – Monitorimi nga afër – Efekt i kufizuar në popullatën e përgjithshme – Ndërhyrjet e fokusuara – Staf i specializuar – Garantimi i sigurisë publike 	<ul style="list-style-type: none"> – Lidhje të reja dhe më të forta midis të burgosurve – Dobësimi i besimit ndërmjet stafit dhe të burgosurve – Ngulitja e mendësive kundërshtuese – Përforcimi i perceptimeve të padrejtësisë – Efektet e etikimit, stigmatizimit – Statusi që shoqëron qëndrimin në një njësi të veçantë – Të gjithë VEO-të supozohen se paraqesin rrezik të barabartë – Vështirësitë për të gjetur staf – Kosto e të lartë financiare
Shpërndarja	<ul style="list-style-type: none"> – Më pak stigmatizim dhe marginalizim – Nuk krijohet asnjë status nga vendosja në një njësi të veçantë – Mundësi për ndikim pozitiv nga të tjerët 	<ul style="list-style-type: none"> – Staf i përgjithshëm, kosto trajnimit – Vështirësi për të garantuar cilësi të lartë të informacioneve të zbulimit – Vështirësi në lidhje me njohjen e të burgosurve dhe sigurisë dinamike – Mundësia që VEO-të të ushtrojnë ndikimin e tyre tek të tjerët – Mundësia që VEO-të të ndikohen nga bandat kriminale
Kombinim	<ul style="list-style-type: none"> – Reagim i përshtatur sipas nevojave/rreziqeve individuale 	<ul style="list-style-type: none"> – Kriteret përzgjedhëse/vlerësimi i rrezikut është i pasaktë

Rekomandime kyçe

- Zgjedhjet e regjimit të burgut duhet të udhëhiqen nga qëllimi për të normalizuar VEO-të ndërkohë që minimizohen rreziqet për vetë VEO-të, të burgosurit e tjerë, stafin dhe publikun e gjerë.
- Avantazhet dhe disavantazhet e modeleve të ndryshme të regjimeve të burgjeve të disponueshme për menaxhimin e rreziqeve të radikalizimit duhet të konsiderohen me kujdes dhe të peshohen kundrejt nevojave individuale të autorëve. Për të burgosurit që shfaqin sjellje shqetësuese që lidhen me radikalizimin, mund të nevojiten njësi të veçanta, por përdorimi i tyre duhet të udhëhiqet nga kritere të qarta hyrjeje dhe daljeje dhe ato duhet të funksionojnë brenda kuadrove ligjore të vendit përkatës.
- Bërja e dallimit brenda njësive të veçanta është e rëndësishme për të përshtatur përpjekjet e sigurisë dhe rehabilitimit sipas niveleve të ndryshme të rreziqeve dhe nevojave sipas nivelit të veprës, gjinisë dhe sfondit ideologjik.
- Pavarësisht zgjedhjes së regjimit, burgjet duhet të jenë të pajisura me një instrument për të vlerësuar vendosjen më të përshtatshme të të burgosurve dhe të ofrojnë trajnime të përshtatshme për stafin (të përgjithshme ose të specializuara).

Ndërhyrjet rehabilituese

Përdorimi i strukturave dhe proceseve ekzistuese për planet e individualizuara të dënimit:

Burgjet kanë pak ndërhyrje rehabilitimi specifike për VEO-të dhe ata që dyshohen për radikalizim. Problemet që lidhen me radikalizimin zakonisht trajtohen nëpërmjet strukturave dhe proceseve ekzistuese dhe këto janë të individualizuara për secilin autor si pjesë e planit të tij të dënimit²⁷. Sjellja vlerësohet nëpërmjet ndërhyrjeve psikologjike, veprimtarive të kapelanëve, arsimit dhe punësimit dhe marrëdhënieve të mira ndërmjet stafit dhe të burgosurve. Qasja e gjerë dhe e gjithëpërfshirëse pranon se largimi nga dhuna dhe ekstremizmi është një udhëtim me shumë dimensione dhe shpesh unik. Trajnimi profesional gjatë vuajtjes së dënimit është i rëndësishëm për t'i përgatitur autorët e veprave për lirim dhe largim. Autorët e me dënime më të ulëta kanë më pak mundësi për ndërhyrje në burg.

Ndërhyrja e specializuar psikologjike: Ka vetëm pak shembuj të ndërhyrjeve të specializuara që synojnë drejtpërdrejt VEO-të²⁸. Ato ekzistuese kanë kryesisht natyrë psikologjike dhe kryhen në nivel individual ose në grupe të vogla. Nevoja për ndërhyrje të specializuar varet nga veçoritë e secilit individ.

²⁷ United Nations, "Handbook on the Management of Violent Extremist Prisoners and the Prevention of Radicalization to Violence in Prisons", p. 42.

²⁸ Christopher Dean, 'The Healthy Identity Intervention: The UK's Development of a Psychologically Informed Intervention to Address Extremist Offending', in Prisons, Terrorism and Extremism: Critical Issues in Management, Radicalisation and Reform, ed. Andrew Silke (London: Routledge, 2014).

Përvoja tregon se ndërhyrjet individuale mund të jenë më të vështira për t'u financuar. Gjatë ndërhyrjeve në grup, pjesëmarrësit janë shpesh më pak "të ndershëm", veçanërisht për sa i përket situatës ose pikëpamjeve të tyre individuale. Prishja potenciale e dinamikave të grupit (p.sh. "liderët" radikalë karizmatikë që sfidojnë ndërmjetësuesin) duhet gjithashtu të merret në konsideratë.

Arsimi teologjik dhe mbështetja pastorale: Kapelanët mund të ndihmojnë me arsimin dhe mbështetjen fetare. Kapelanët nuk ofrojnë vetëm arsim fetar, por në rastin e ideologjisë islame të dhunshme, mund të sfidojnë edhe disa pikëpamje të veçanta dhe t'u ofrojnë të dënuarve mundësi që t'i mendojnë çështjet në një mënyrë të ndryshme. Megjithatë, mundësitë për të marrë pjesë në veprimtaritë e kapelanët ndryshojnë midis shteteve anëtare të BE-së, si dhe sipas burimeve, demografisë së çdo burgu dhe qëndrimit të shtetit ndaj fesë. Ndërhyrjet e specializuara teologjike, duke përfshirë seancat e dialogut, siç konstatohet në shtetet me shumicë myslimane, janë të rralla në shtetet anëtare të BE-së. Kujdesi dhe udhëzimi ndonjëherë mbivendosen me deradikalizimin dhe qëllimet parandaluese, për shembull, gjatë ofrimit të këndvështrimeve teologjike alternative, por fokusi parësor i kapelanit nuk duhet të jetë siguria. Nëse kapelanët përfshihen në përpjekjet e shkëputjes/deradikalizimit, ata duhet të kenë përvojën dhe trajnimin e përshtatshëm për ta bërë diçka të tillë. Fakti se ata kanë arsim fetar nuk mjafton për të kryer ndërhyrje të specializuara me VEO-të.

A e dinit se?

Feja në burgje dhe shteti²⁹: ekzistenca e departamenteve të kapelanëve për VEO-të dhe individët me lidhje të mundshme me radikalizimin është e ndryshme në shtete të ndryshme anëtare të BE-së. Franca, për shembull, nuk i njeh formalisht kapelanët myslimanë si pjesë e sistemit të burgjeve, ndërsa në Angli dhe Uells kapelanët janë të punësuar formalisht nga shteti dhe përfshirja e tyre në vlerësimin e rrezikut është në rritje³⁰, megjithëse kjo nuk ka kaluar pa kundërshtime, duke qenë se mund të prishë besimin e të burgosurve³¹. Është e rëndësishme që kapelanët të respektohen nga të burgosurit dhe roli i tyre të jetë qartësisht i ndarë nga siguria, në mënyrë që ata të ruajnë besimin e të burgosurve dhe të ofrojnë kujdes dhe udhëzim pastoral dhe shpirtëror.

Mbështetja sociale: Ofrimi i mundësive që autorët e veprave të ruajnë lidhje të ngushta me rrjetet e familjarëve dhe miqve është thelbësore për të mundësuar kalimin nga burgu në liri. Studimet për largimin e kriminelëve në përgjithësi, dhe VEO-ve në veçanti, për sa i përket deradikalizimit dhe shkëputjes, mbështet rëndësinë që kanë lidhjet sociale në këto procese. Ndërhyrje të tilla si projektet e këshillimit mund të përdoren edhe për të ofruar mbështetje sociale dhe për të ndihmuar në vendosjen e marrëdhënieve të bazuara në besim, për shembull me stafin, anëtarë të komunitetit

²⁹ Ryan J. Williams and Alison Liebling, 'Faith Provision, Institutional Power and Meaning among Muslim Prisoners in Two English High Security Prisons', in Religion in Prison, ed. Kent Kerley (Praeger, in press).

³⁰ James Beckford, Daniele Joy dhe Farhad Khosrokhavar, Muslims in Prison: Challenges and Change in Britain and France (Basingstoke, England & New York: Palgrave MacMillan, 2005).

³¹ Sophie Gilliat-Ray, Stephen Pattison, and Mansur Ali, Understanding Muslim Chaplaincy (Surrey, UK: Ashgate, 2013).

dhe profesionistë nga OJQ-të. Është e rëndësishme të vlerësohet nëse rrethi familjar dhe social janë partnerë në një proces shkëputjeje dhe jo stimulues të një mendësie ekstremiste. Nëse kjo e fundit është e vërtetë, atëherë mbështetja sociale duhet të jepet nëpërmjet rrugëve të tjera (në përputhje me rregulloret ligjore dhe ato për të drejtat e njeriut).

Rekomandime kyçe

- Ndërhyrjet për rehabilitim duhet të mbështeten nëpërmjet vlerësimit të rrezikut dhe nevojave, ndërsa planet e dënimit për VEO-të duhet të përfshijnë plane të përshtatura ndërhyrjeje. Kjo mund të bazohet në strukturat ekzistuese, nëse ka, por mund të përfshijë edhe ndërhyrje të specializuara.
- Mbështetjet psikologjike mund të jepen mbi baza individuale ose në grup. Megjithëse më të kushtueshme, ndërhyrjet individuale duhet të kenë përparësi ndaj ndërhyrjeve në grup për shkak të ndikimit potencial negativ të këtyre të fundit në dinamikën e grupit.
- Ofrimi i mbështetjes fetare dhe shpirtërore është faktor kyç dhe mund të ketë një ndikim shkëputës të VEO-të me ideologji fetare. Megjithatë, nëse kapelanët përfshihen qëllimisht në përpjekjet e shkëputjes/deradikalizimit, ata duhet të kenë përvojë dhe të jenë trajnuar në këtë fushë. Duhet të merret në konsideratë besueshmëria dhe legjitimiteti i tyre në sytë e autorëve dhe komunitetit më të gjerë.
- Mbështetja sociale është e rëndësishme për shkëputjen dhe lirim. Bashkëpunimi me familjen dhe miqtë si partnerë në procesin e shkëputjes jep rezultate nëse rrethi shoqëror nuk ka qenë në fillim një faktor në procesin e radikalizimit. Duhet të merren në konsideratë edhe mënyra të tjera të mbështetjes sociale (p.sh. programet e këshillimit ose përfshirja e komunitetit).

Trajnimi dhe mbështetja e stafit

Shoqëria evropiane në përgjithësi dhe po ashtu edhe shoqëritë e të burgosurve janë bërë më të larmishme dhe më komplekse. Ndjeshmëria dhe mirëkuptimi i normave, vlerave dhe shprehive kulturore dhe fetare sa vjen e bëhen më të rëndësishme për të pasur një marrëdhënie të mirë ndërmjet stafit dhe autorëve të veprave. Nuk është e nevojshme që të gjithë anëtarët e stafit të jenë ekspertë të ideologjive ose besimeve fetare specifike. Megjithatë, është e nevojshme që oficerët e institucioneve të riedukimit të kenë njohuritë bazë për prejardhjen fetare dhe kulturore të personave me të cilët punojnë. Paragjykimi, pasiguria dhe frika nga autorët mund të çojnë në mbiraportim dhe ndërveprime negative me të burgosurit dhe mund të kontribuojnë në marginalizimin e tyre dhe të krijojë një atmosferë dyshimi dhe mosbesimi reciprok.

Trajnim i përgjithshëm: Në mënyrë që trajnimi për temën specifike të radikalizimit të ketë rezultate, nevojitet një nivel i caktuar i profesionalizmit të stafit. Trajnimet më të specializuara të të gjithë stafit të vijës së parë të burgjeve dhe shërbimit të provës duhet të përfshijnë të kuptuarit e rrethanave që mund të çojnë në ekstremizëm të dhunshëm (shih Vlerësimi i rrezikut dhe mbështetja, f. 9). I gjithë stafi i vijës së parë në burgje dhe shërbimin e provës duhet të jetë

i trajnuar për të njohur proceset e radikalizimit. Theksojmë se kjo qasje nuk duhet të kërkojë “shenja” radikalizimi, duke qenë se ato shpesh janë subjekt i pozitivitetit të rremë dhe keqkuptimit. Në fakt, ajo çka nevojitet është njohja e autorit individual dhe njohja e rolit të mjediseve jo të sigurta të burgut (shih “mjedise të shëndetshme të burgjeve”, f. 6), duke përfshirë mungesën e burimeve dhe rrugëve mbështetëse për arritjen e zhvillimit personal dhe shpresës. Stafi duhet të tregojë kujdes që të mos krijojë armiqësi ndërmjet stafit dhe të burgosurve, si dhe mes vetë të burgosurve, dhe duhet ta kryejë punën me VEO-të dhe të tjerët që rrezikohen nga radikalizimi me respekt, drejtësi dhe empati.

Trajnim i specializuar: Stafi që punon drejtpërdrejtë me terroristë të dënuar duhet të ketë disa aftësi specifike dhe jo të gjithë anëtarët e stafit janë të përshtatshëm. Trajnimi normalisht mbulon një sërë praktikash profesionale, duke përfshirë sa vijon: njohja e rrugëve që të çojnë në ekstremizëm të dhunshëm, njohja e shenjave paralajmëruese të radikalizimit dhe tipareve të regjimeve pozitive, kryerja e vlerësimit të informacioneve të zbulimit, respektimi i standardeve etike, aftësitë ndërpersonale, menaxhimi i stresit dhe diversiteti fetar dhe kulturor³².

Stafi i specializuar zakonisht mund të ndahet në dy kategori: oficerë të rregullt që punojnë në një sektor ose njësi të specializuar (p.sh. sektori për terroristët) dhe ata që mbledhin informacione nga ekspertë të tjerë (këta mund të jenë punonjësit socialë, psikologët etj.). Ky staf i specializuar kryen vlerësime dhe menaxhon ndërhyrjet/programet. Nevojitet mbështetje për këtë staf të specializuar, i cili shpesh angazhohet në një luftë për “nivel të lartë moral” dhe duhet të fitojë besimin e autorëve të veprave.

Një qasje e zgjuar do të ishte që të ofrohen një trajnim i përgjithshëm ndërgjegjësimit për të gjithë stafin dhe një trajnim i specializuar për stafin që punon drejtpërdrejtë me terroristët e burgosur. Anëtarët e stafit duhet të mbështeten për të menaxhuar ankthin dhe për të qenë konfidentë për vendimet e tyre, si ato të bazuara në rezultatet e instrumentit të vlerësimit, ashtu edhe ato të bazuara në intuitat e tyre profesionale. Duhet të ngrihet një strukturë mbështetëse që përfshin kolegë, psikologë dhe drejtues të burgut. Duhet të ngrihet një njësi trajnimit dhe mbështetjeje në nivel kombëtar për të përditësuar dhe shpërndarë materialet e kursit të trajnimit dhe për të ofruar mbështetje për stafin dhe drejtuesit e burgjeve. Njësia kombëtare e trajnimit dhe mbështetjes duhet të lidhet edhe me shtetet e tjera anëtare për të ndarë modelet e praktikave më të mira dhe materialet e trajnimit.

³² United Nations, ‘Handbook on the Management of Violent Extremist Prisoners and the Prevention of Radicalization to Violence in Prisons’, p. 30.

Rekomandime kyçe

- Trajnimi i stafit duhet të përfshijë temën e diversitetit për të përmirësuar njohuritë për origjinën e ndryshme kulturore dhe fetare të të burgosurve, në mënyrë që stafi të ketë mundësi të kuptojë se cilat sjellje dhe praktika mund të jenë të lidhura me radikalizimin dhe cilat jo.
- Stafi duhet të jetë i trajnuar për të njohur radikalizimin dhe arsyet individuale, sociale dhe mjedisore të sjelljes së të burgosurve. Kërkimi për “shenjat” e radikalizimit duhet të bëhet në kontekstin më të gjerë të njohjes së pikave të dobëta të të burgosurve dhe nevojave të tyre për mbështetje. Stafi duhet të kuptojë procesin dhe jo vetëm të kërkojë për “shenja”.
- Trajnimi i përgjithshëm duhet të ofrohet për të gjithë, dhe trajnimi i specializuar nevojitet për pozicione të ndryshme pune dhe në proporcion me popullatën e të burgosurve që konsiderohen si të rrezikuar.
- Një njësi kombëtare trajnimi dhe mbështetjeje për stafin e burgjeve mund të ndihmojë për shpërndarjen e materialeve të trajnimit, zhvillimin e praktikave më të mira të trajnimit dhe nivelet e mbështetjes psikologjike që i ofrohet stafit. Ajo gjithashtu mund të përforcojë bashkëpunimin në nivel lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar dhe të lehtësojë shkëmbimin e praktikave më të mira dhe materialeve të trajnimit.

Konteksti i shërbimit të provës

Shërbimet përgjegjëse për autorët e veprave në kontekstet pas lirimit mbajnë një barrë gjithmonë e më të madhe ndërkohë që kërkojnë të menaxhojnë rreziqet që lidhen me ekstremizmin e dhunshëm duke garantuar në të njëjtën kohë që autorët të marrin mbështetje dhe të riintegrohen pas lirimit. Me zgjerimin e përkufizimit të veprave të lidhura me terrorizmin dhe shkurtimin e dënimeve (më pak se katër vjet, ku disa madje vuajnë një dënim dyjavor), mundësitë për rehabilitimin e autorit në burg mund të jenë shumë të vogla. Larmia e autorëve, ku përfshihen të rinjtë dhe një numër në rritje i grave të dënuara për veprave të lidhura me terrorizmin, duhet të merret në konsideratë dhe të trajtohet në një qasje unike. Në këtë kontekst të ri, nevojitet bashkëpunimi ndërsektorial ndërmjet burgjeve, shërbimit të provës (ose ekuivalente), policisë dhe ofruesve të shërbimeve komunitare për të garantuar që informacioni të ndahet dhe që autorët dhe ish-autorët e veprave të përfitojnë nga strukturat e nevojshme të ndërhyrjeve dhe mbështetjes. Bashkëpunimi ndërsektorial dhe planifikimi për lirim duhet të fillojmë shumë më përpara datës së lirimit, mundësisht të paktën gjashtë muaj më herët, për të garantuar që shkëmbimi i informacionit të jetë i mundur dhe i vazhdueshëm dhe shërbimet e mbështetjes të jenë ngritur.

Lirimi dhe riintegrimi i VEO-ve: praktikat e mira të përgjithshme

Riintegrimi ka si qëllim të parandalojë sjelljet e dhunshme dhe të mundësojë përfshirjen dhe pjesëmarrjen në shoqëri. Ndjesia e përkatësisë dhe pranimit e bën përkushtimin ndaj dhunës më pak të qëndrueshëm. Idetë radikale në vetvete nuk janë të rrezikshme, megjithëse mund të

jenë një faktor rreziku për sjellje të dhunshme në rrethana të caktuara. Studimet pas lirim të VEO-ve janë të kufizuara dhe dihet shumë pak për faktorët që ndihmojnë në risistemimin e tyre. Megjithatë, si praktikë e mirë:

Planet e risistemimit: Në programin e punës për autorin e veprës duhet të përfshihen plane sa më herët që të jetë e mundur gjatë kohës së vuajtjes së dënimit. Vlerësimi i rreziqeve dhe nevojave është një instrument kyç për të hartuar një program efektiv riintegrimi. Shërbimet e provës (ose një institucion kombëtar ekuivalent) duhet të bashkëpunojnë për këtë vlerësim gjatë fazës së fundit të vuajtjes së dënimit në burg. Ky bashkëpunim ndërinstitutional mund të ofrojë udhëzime për formën më të mirë që mund t'i jepet procesit të riintegrimin.

Menaxhimi i tranzicionit: Periudhat e tranzicionit janë ato pika në kohë kur rreziku i recidivizmit është i lartë dhe kur është e rëndësishme që të hartohen plane përpara vuajtjes së dënimit të plotë. Këto plane duhet të përfshijnë mënyrat e trajtimit të jetës familjare e personale problematike dhe të shfrytëzojnë kapitalin njerëzor dhe social për të ulur gjasat për kryerjen e veprave të reja.

Vlerësimi i individualizuar i rrezikut dhe nevojave: Njohja e individit dhe reagimi i përshtatur sipas rrethanave dhe sfidave të tyre specifike është e rëndësishme po aq sa mundësimi i procesit të shkëputjes dhe/ose deradikalizimit duke pasur si synim potencialin për të kontribuar në shoqëri. Rekomandohen ekipe multidisiplinore për të vlerësuar nevojat dhe rreziqet individuale të autorit të veprës.

Ngritja e kapaciteteve: Planifikimi për përfundimin e mbështetjes dhe ngritja e kapaciteteve të një individi për t'u mbështetur tek të tjerët dhe për të përballuar situatën, duke përfshirë mbështetjen sociale dhe organizative (shih në vijim) janë kritike.

Besimi: Besimi është faktori qendror për punën efektive të shërbimit të provës dhe shpesh procesi i lidhjes së autorëve të veprave ekstremiste me oficerët e shërbimit të provës bëhet duke marrë parasysh besimin. Oficerët e shërbimit të provës që kanë një përkatësi kulturore dhe fetare të ngjashme me autorin e veprës mund të ndihmojnë në ndërtimin e besimit.

Mbështetja sociale dhe organizative - bashkëpunimi me të tjerët për të arritur shkëputjen: Teoritë e shkëputjes, ato që kërkojnë të kuptojnë se si një individ largohet ose shkëputet nga krimi, sugjerojnë se shkëputja arrihet në bashkëpunim me të tjerët. Këta "të tjerë" mund të përfshijnë oficerët e institucioneve të riedukimit dhe persona të tjerë të qarqeve sociale. Përfaqësuesit e të gjitha organizatave bashkëpunuese, ku përfshihen organizatat komunitare që ndihmojnë në kërkimin për punë ose në udhëheqjen fetare ose shpirtërore dhe shërbimet sociale, duhet të shërbejnë për të përmbushur nevojat për mbështetje sociale dhe për të ulur burimet e rrezikut. Miqtë, anëtarët e familjes dhe persona të tjerë të rëndësishëm dhe marrëdhënie të rëndësishme janë thelbësore për rrugën drejt shkëputjes dhe për përforcimin e pikëpamjeve pozitive të sjelljes jo të dhunshme, si edhe për krijimin e një identiteti pozitiv. Në ndikim pozitiv mund të kenë gjithashtu personat që supozohet se kanë autoritet mbi autorin e veprës, si liderët fetarë, mësuesit ose personat të cilët më parë kanë pasur të njëjtat besime dhe sjellje, por janë shkëputur nga sjellja e dhunshme dhe tashmë shërbejnë si këshillues.

A e dinit se?

Vënia e theksit tek e mira që gjendet te çdo njeri: “Modeli i jetës së mirë” (GLM) është një qasje pozitive e bazuar në pikat e forta që ndihmon në shkëputje dhe rehabilitim. Modeli pranon se ulja e nevojave kriminologjike është e nevojshme, por jo e mjaftueshme për të pasur ndërhyrje efektive. GLM merr në konsideratë, në mënyrë më të gjerë dhe më konstruktive, të mirën që gjendet te çdo njeri, “përvojat, veprimtaritë, gjendjet që lidhen fort me mirëqenien dhe nivelet e larta të kënaqësisë personale dhe funksionit shoqëror”³³. Ky konsiderim më i gjerë i personit, ku përfshihen shpresat, objektivat dhe qëllimi i tij në jetë, është thelbësor për të mundësuar proceset e shkëputjes për autorët e veprave e dënuar për vepra penale të lidhura me terrorizmin.

Marrëdhëniet pozitive janë thelbësore për të mbështetur proceset e shkëputjes dhe/ose deradikalizimit dhe këto duhet të mundësohen nëpërmjet krijimit të marrëdhënieve njerëzore. Qëllimi i këtyre marrëdhënieve duhet të jetë:

- ofrimi i mbështetjes kur nevojat kriminogjenike (nevojat që lidhen drejtpërdrejtë me gjasat që një person të kryejë një krim, p.sh. mungesa e një aftësie të caktuar) identifikohen nëpërmjet instrumenteve të përshtatshme të vlerësimit;
- ofrimi i mbështetjes sipas problemeve që vetë autorët e veprave përcaktojnë si kryesore për situatën e tyre dhe si arsye potenciale për sjelljen e dhunshme;
- dhënia e ndihmës që autorët e veprave të njohin dhe të kuptojnë pikat e forta, kapacitetet, aftësitë e mundshme të tyre etj., dhe t’i shfrytëzojnë ato për qëllimin e duhur;
- ofrimi i sugjerimeve dhe mundësive për pjesëmarrje në komunitet, si p.sh. nëpërmjet grupeve kulturore ose sportive;
- mbështetja e autorit të veprës për të përcaktuar në mënyrë realiste “jetën e mirë” dhe për të gjetur mënyra për ta arritur diçka të tillë në praktikë;
- nxitja e ripërkufizimit të identitetit të autorit të veprës nëpërmjet reagimeve pozitive që mbështesin shpresën, përkatësinë dhe riintegrimin.

³³ Tony Ward and Shadd Maruna, *Rehabilitation* (Taylor & Francis, 2007). p. 21

Rekomandime kyçe

- Autorët e veprave duhet të marrin mbështetje të vazhdueshme që nga koha e vuajtjes së dënimit deri në lirimin e tyre, veçanërisht për dënimet e shkurtra që jepen tani për krimet e lidhura me terrorizmin, dhe për shkak se janë pikërisht periudhat e tranzicionit ato që paraqesin rrezikun më të lartë për recidivizëm.
- Bashkëpunimi ndërinstytucional është thelbësor për të garantuar një tranzicion pa probleme nga burgu në komunitet dhe për të maksimizuar mundësitë që nevojat e autorëve të veprave të vlerësohen dhe të përmbushen siç duhet. Ky bashkëpunim duhet të jetë pjesë e planifikimit për fazën pas lirimimit dhe të përfshijë një ekip multidisiplinor.

Ndërhyrje (të specializuara)

Ndërhyrjet, strukturat mbështetëse dhe praktikrat e menaxhimit të rrezikut mund të hartohen posaçërisht për VEO-të, ose ato mund të jenë më të përgjithshme në qasje, si për shembull, duke ofruar mundësi profesionale dhe duke lehtësuar mbështetjen nga familja³⁴. Fakti nëse do të përdoret ose jo një qasje profesionale varet nga nevojat e autorit të veprës. Disa shtete anëtare (p.sh. Franca, Holanda dhe Mbretëria e Bashkuar) kanë programe vullnetare që mundësojnë një sërë ndërhyrjesh të mundshme:

- **Autorët e veprave duhet të marrin mbështetje në vazhdimësi**, që nga burgu derisa të lirohen. Koha kur ish-autorët janë më vulnerabël janë javët e para pas lirimimit. Përshtatja mund të jetë e vështirë si për ish-autorët e veprave ashtu edhe familjet e tyre. Një mënyrë për të garantuar këtë mbështetje është që të merren masat për një këshillues ose ndërmjetësues për autorët e veprave përpara dhe pas lirimimit. Ky këshillues ose ndërmjetësues duhet të punojë me individin gjatë gjithë vuajtjes së dënimit dhe duhet të mbetet një pikë kontakti dhe mbështetjeje edhe pas lirimimit.
- **Përmbushja e nevojave të VEO-ve për mbështetje materiale dhe sociale:** Bashkëpunimi i strukturuar me ofruesit e shërbimeve, si agjencitë e strehimit, agjencitë e punësimit, institucionet e arsimit, ofruesit e kujdesit shëndetësor dhe shërbimeve familjare, është thelbësor për t'i ofruar ish-autorëve të veprave mundësi për t'u riintegruar dhe për të rindërtuar jetën pas lirimimit. Kjo duhet të kryhet nëpërmjet planeve të risistemimit përpara lirimimit, ku të përfshihet edhe çdo nevojë sociale. Krijimi dhe mbështetja e marrëdhënieve, zhvillimi i lidhjeve sociale pozitive, mbështetja dhe stimulimi i pikave të forta dhe aftësive personale, nxitja e shpresës dhe ofrimi i udhëzimeve mbi çështje fetare dhe shpirtërore janë gjithashtu të rëndësishme për riintegrimin në shoqëri dhe për një jetë pa vepra penale. Forma e saktë e mbështetjes varet nga nevojat e brendshme dhe të jashtme të autorit të veprës. Për shkak të stigmës që shoqëron veprat terroriste, ofrimi i mbështetjes së këtij lloji mund të jetë më i vështirë për VEO-të (shih "Barrierat e riintegrimit", f. 23).

³⁴ Radicalisation Awareness Network, 'Ex Post Paper Ran Exit' ed. RAN P&P (Amsterdam2016).

- **Ndërhryrjet në bashkëpunim me rrethin shoqëror të autorit të veprës.** Studimet për shkëputjen kanë treguar rëndësinë që kanë lidhjet e forta shoqërore në nxitjen e të dënuarve që të përvetësojnë një stil jetese pa vepra penale. Përfshirja e rrethit shoqëror të ish-autorit të veprës, veçanërisht të atij familjar³⁵ në ndërhryrje, ofron mbështetjen kyçe për proceset e shkëputjes. Kjo mund të përfshijë përfshirjen e familjarëve në vendimmarrjen e profesionistëve për ish-autorin, duke u caktuar atyre detyra ose përgjegjësi për të ndihmuar ish-autorin dhe për t'i ofruar trajnim që i përgatit ata se si të sillen me personin e tyre të dashuri kur ndërhryrja të përfundojë. Personat e rrethit shoqëror të autorit që kanë ndikim negativ nuk duhet të përfshihen, por duhet të tregohet kujdes në identifikimin e këtyre ndikimeve negative. Praktika premtuese në këtë fushë mund të frymëzohen nga qasja e “rrjetit shoqëror të përfitimeve” që përdoret për autorët e mitur që janë në paraburgim ose gati për t'u liruar, të cilët rrethohen nga rrjete personash të rëndësishëm që i mbështesin. Të gjithë nënshkruajnë një kontratë të miratuar nga i dënuari. Kontrata detyruese cakton përgjegjësitë në rrjetin e autorit të veprës dhe ky shërben si një rrjet shoqëror i sigurisë. Austria është duke eksperimentuar me diçka të tillë.
- **Ndërhryrjet teologjike dhe mbështetja nga komunitetet fetare.** Këto ndërhryrje të specializuara mund të ofrohen në burg dhe pas lirit. Komunitetet fetare, duke përfshirë vullnetarët dhe imamët, luajnë një rol të rëndësishëm në mbështetjen e autorëve të veprave pas lirit të tyre, ndërsa mungesa e mbështetjes sociale dhe shpirtërore mund të rrisë vulnerabilitetin pas lirit. Të dënuarit mund të përfitojnë nga këshillimi fetar i përgjithshëm ose nga ndërhryrjet e përshtatura fetare dhe teologjike. Ndërhryrjet e specializuara mund të mbështeten ose nga një qasje teologjike, kur qëllimi është kundërshtimi i disa besimeve ideologjike specifike, ose mund të marrin një formë të një qasjeje konjitiv dhe të sjelljes. Profesionistët duhet të përpiqen t'i përdorin këto burime të komunitetit si pjesë e një rrjeti mbështetës që vihet në dispozicion për të ndihmuar ish-autorin gjatë rrugëtimit të tij për t'u shkëputur ose riintegruar. Ashtu sikurse si me skemat e këshillimit dhe punës me anëtarët e familjes, për individët e përfshirë duhet të kryhet vlerësimi i përshtatshëm i rrezikut.
- **Programet e këshillimit.** Disa shtete anëtare të BE-së (Danimarka, Mbretëria e Bashkuar) kanë ngritur një sistem këshillimi për individët e radikalizuar që dëshirojnë të largohen nga ekstremizmi i dhunshëm³⁶. Këta këshillues, të cilët shërbejnë si shembull për t'u ndjekur dhe udhëzues në shoqëri, mund të jenë vullnetarë të trajnuar. Disa mund të jenë “ish-ekstremistë” me të kaluar si ekstremistë të dhunshëm dhe me përvojë në aspektin e largimit nga ai mjedis³⁷. Ata e njohin situatën në të cilën gjendet personi, mund të ofrojnë udhëzime për rrugën që duhet ndjekur për t'u larguar nga ekstremizmi dhe të tregojnë stile jetese alternative. Disa këshillues të tjerë mund të vijnë nga organizatat fetare ose të komunitetit dhe mund ta mbështesin të dënuarit në një sërë mënyrash, duke përfshirë ndihmën e përditshme (p.sh. plotësimi i aplikimeve për punë). Shqyrtimi i imtësishëm i këshilluesve për t'u siguruar që të

³⁵ Basia Spalek, 'Radicalisation, De-Radicalisation and Counter-Radicalisation in Relation to Families: Key Challenges for Research, Policy and Practice', Security Journal 29, no. 1 (2016).

³⁶ Basia Spalek and Lynn Davies, 'Mentoring in Relation to Violent Extremism: A Study of Role, Purpose, and Outcomes', Studies in Conflict & Terrorism 35, no. 5 (2012).

³⁷ Forumi Global i Luftës kundër Terrorizmit, "Rome Memorandum on Good Practices for Rehabilitation and Reintegration of Violent Extremist Offenders".

mos kenë programe të fshehura dhe për të pasur një proces të mirë përputhjeje ndërmjet këshilluesit dhe autorit të veprës është çelësi i suksesit.

- **Shërbimet e shëndetit mendor.** Gjithmonë e më shumë të dhënat dhe përvoja mbështesin një lloj lidhjeje ndërmjet të autorëve të veprave të radikalizuar (dhe individëve të radikalizuar në përgjithësi) dhe problemeve të shëndetit mendor. Nevojiten shërbime dhe vlerësime të shëndetit mendor në burg dhe pas lirimit, për të siguruar që individi të marrë mbështetjen e nevojshme.

Rekomandime kyçe

- Duhet të vihen në dispozicion një sërë qasjesh të specializuara dhe të përgjithshme për të mbështetur VEO-të pas lirimit të tyre, si skemat e mbështetjes materiale dhe sociale, nismat e mbështetjes nga familja dhe miqtë, këshillimi fetar, seancat e dialogut, programet e këshillimit dhe bashkëpunimi me shërbimet e shëndetit mendor.
- Nismat duhet të përshtaten me nevojat individuale të autorit të veprës dhe të përfshijnë vëmendjen ndaj nevojave materiale, ekonomike, sociale, shpirtërore dhe fetare.

Barrierat për riintegrimin

Prej kohësh studimet kanë treguar se një i dënuar përballet me vështirësi të konsiderueshme në përpjekjet për t'u bërë një "qytetar i rikualifikuar" pasi lirohet nga burgu dhe se këto vështirësi marrin shumë forma, duke përfshirë ato ekonomike, të marrëdhënieve dhe emocionale. Individët e dënuar për vepra penale terroriste përballen me barriera të tjera. Veprat penale terroriste shoqërohen me burime unike stigmatizimi dhe në disa kontekste ky etiketim negativ mund të përvetësohet dhe të shërbejë si simbol i statusit në komunitetet e marginalizuara.

Stigmatizimi: I dënuari i stigmatizuar përballet me sfida që lidhen me qasjen në mbështetjen sociale dhe mundësitë për t'u riintegruar, duke përfshirë qasjen në punësim ose arsim. Në të gjitha aspektet, profesionistët që punojnë me VEO-të duhet të pranojnë potencialin e tyre për t'u riintegruar në shoqëri dhe duhet t'i mbështesin ata në përpjekjet e tyre për të arritur këtë objektivi. Paragjykimet ndaj të dënuarve mund të vendosin barriera dhe të përforcojnë identitetet kundërshtuese dhe të radikalizuara.

Besimi: Është shumë e rëndësishme që profesionistët të punojnë për të krijuar dhe ruajtur besimin e ish-autorit dhe segmenteve më të gjera të publikut. Mosbesimi te komunitetet ose organizatat e komunitetit mund të përforcojë perceptimet e padrejtësisë ndërmjet anëtarëve të komunitetit. Shërbimet e provës në shtetet anëtare (ose institucionet ekuivalente) mund të përfitojnë nga ndërtimi i marrëdhënieve të forta të besimit me organizatat e komunitetit. Kjo garanton që disa sektorë të shoqërisë të rrisin mundësitë për të dënuarit pas lirimit të tyre.

Kushtet e lirimit: Kushtet për këta autorë veprash mund të jenë shumë të rrepta dhe shkojnë përtej atyre që vendosen për lloje të tjera autorësh. Kjo mund të pengojë riintegrimin, për shembull, kur

është e lehtë që të dënuarit të kthehen sërish në burg për veprën e tyre. Megjithatë, profesionistët mund të përdorin këto kushte, dhe kontaktin më të shpeshtë që nënkuptohet nga këto kushte, si mundësi për të punuar me autorët e veprave dhe për t'iu përgjigjur nevojave të tyre.

Trajnimi i stafit

Puna e shërbimeve të provës me VEO-të shkon përtej detyrave të zakonshme të punonjësve të shërbimit të provës. Klima sociale dhe politike në lidhje me ekstremizmin rrit nivelet e stresit për ata që punojnë me këta autorë veprash, ndërkohë që politikat mund të ndryshojnë shpejt dhe mund të udhëhiqen nga aspektet politike dhe jo nga ajo që konsiderohet si gjëja më e mirë për të dënuarin. Në punën me VEO-të rreziku nuk pranohet lehtësisht, gjë që do të thotë se pasojat e gabimeve që mund të bëhen me këtë grup shqyrtohen me kujdesin më të madh nga drejtuesit politikë dhe publiku i gjerë. Kjo mund të kufizojë gjykimin profesional të oficerëve të shërbimit të provës. Oficerëve mund t'u duket se puna e tyre i nënshtrohet shqyrtimit të imët politik dhe ekuilibri ndërmjet presioneve sociale dhe politike dhe asaj që i shërben më mirë interesave të autorit të veprës për t'u integruar është i brishtë. Kjo nuk pritet që të ndryshojë në të ardhmen e parashikueshme.

Punonjësit e shërbimit të provës kanë nevojë për trajnim të specializuar në lidhje me vlerësimin siç duhet nevojat e autorëve të veprave (shih "trajnimi dhe mbështetja e stafit" f. 18). Ajo që shtyn të dënuarin mund të jetë ose jo ideologjia, dhe nevojitet trajnim i specializuar dhe përvojë për të kuptuar dhe vlerësuar se kur duhet marrë në konsideratë ideologjia dhe kur duhet të kërkohen mënyra të tjera për të trajtuar sjelljen e autorit të veprës. Punëtorët e shërbimit të provës kanë gjithashtu nevojë për mbështetje nëpërmjet diskutimeve, trajnimit për menaxhimin e stresit dhe për mbështetjen e kolegëve dhe eprorëve.

Rekomandime kyçe

- Autorët e dënuar për vepra të lidhura me terrorizmin përballen me sfida unike gjatë riintegritimit në komunitet për shkak të kushteve më të rrepta, stigmatizimit dhe problemeve të besimit. Këto duhet të planifikohen përpara liritimit dhe të trajtohen së bashku me nevojat materiale (punësimi, arsimi, strehimi);
- Stafi përballlet me një presion të jashtëzakonshëm gjatë punës me këtë kategori autorësh të veprave dhe kërkon qasje në trajnim dhe mbështetje për ta përmbushur rolin siç duhet.

Përfundimet e dokumentit të punës

Sfidat që presin punonjësit e burgjeve dhe shërbimeve të provës që punojnë me VEO-të janë në rritje dhe në ndryshim. Numri i individëve që mbahen në burg për vepra të lidhura me terrorizmin është në rritje dhe nevoja për t'iu përgjigjur siç duhet rreziqeve dhe nevojave të këtyre autorëve, si dhe për t'i përgatitur ata për lirim në shoqëri është në rritje.

Sfida të tjera lindin nga konteksti politik në ndryshim dhe pasiguria nga kërcënimet terroriste, ndaj do të jetë tejet e rëndësishme që të kuptohen dhe të ruhen praktikat më të mira. Shtetet anëtare do të duhet të alokojnë burimet e kufizuara në një mënyrë që kontribuon në përmirësimin e përgjithshëm të klimës në burgje dhe në shtimin e ndërhyrjeve të specializuara për të monitoruar dhe menaxhuar rreziqet dhe për të kontribuar në rehabilitimin dhe risistemimin e VEO-ve. Këto vendime do të bazohen në numrin e individëve që paraqesin rrezik dhe llojin e radikalizimit që po konsiderohet (duke përfshirë radikalizimin e frymëzuar nga feja, nga krahu i djathtë, krahu i majtë ose separatistët).

Besimi dhe kompetencat e profesionistëve të kësaj fushe në të gjitha shtetet anëtare janë në rritje. Është pranuar se investimi për ndërveprime të përditshme të cilësisë së lartë ndërmjet stafit dhe të burgosurve - siguria dinamike - është një hap pozitiv drejt minimizimit të rreziqeve të radikalizimit. Po bëhet edhe një lëvizje për të normalizuar VEO-të, megjithëse jo të gjitha vendet përballen me të njëjtën shkallë rreziku dhe disa nuk janë në gjendje t'i normalizojnë disa VEO për shkak të rreziqeve që ata përfaqësojnë për popullatën e të burgosurve dhe/ose publikun. Vlerësimet e rrezikut dhe ndërhyrjet e specializuara tashmë po pilotohen dhe po përdoren në një mënyrë dinamike për të vlerësuar nevojat dhe rreziqet e autorëve të veprave. Praktikrat më të mira në këtë fushë janë ato të individualizuara dhe që i përgjigjen nevojave të autorit të veprës.

Megjithatë, nevojitet një saktësim i mëtejshëm. Praktikrat në të gjitha shtetet anëtare të BE-së janë gjithnjë në ndryshim dhe kjo e bën të vështirë identifikimin e vendeve që përdorin praktika të veçanta. Arsyetimi pas vendimeve që çojnë në miratimin e politikave dhe praktikave të veçanta duhet të jetë më transparent dhe të bazohet në njohuri më të gjera për praktikrat më të mira.

Gjithashtu, baza e provave vazhdon të jetë e dobët. Vendimmarrja rrallëherë bazohet në prova. Studimet duhet të vihen në praktikë që në fazë të hershme. Nevojiten studime për të kuptuar kontekstet në të cilat lulëzon radikalizimi (dhe ku rreziqet e tij zvogëlohen) dhe në lidhje me aspektet që i ndihmojnë autorët e veprave të riintegrohen në shoqëri. Vlerësimet e rreziqeve duhet t'i nënshtrohen një vlerësimi të të dhënave të bollshme empirike dhe të krahasohen me lloje të tjera të praktikave të menaxhimit të rrezikut për të përcaktuar se cilat metoda dhe qasje janë më efektive. Gjithashtu, duhet të vlerësohet trajnimi i stafit duke i kushtuar vëmendje faktit nëse ai përmirëson marrëdhëniet ndërmjet stafit dhe të burgosurve dhe aftësinë për të menaxhuar rreziqet e lidhura me radikalizimin. Informacioni për praktikrat e bazuara në prova në të ardhmen mund të sigurohet nëpërmjet studimeve të kryera në partneritet.

Për vitin 2017, grupit të punës RAN P&P do t'i duhet t'i vendosë gjithë këto sfida sipas përparësisë dhe t'i trajtojë ato në bazë të njohurive dhe përvojës së punonjësve të burgjeve dhe shërbimeve të provës. Fokusi për këtë vit do të jetë:



- Përballja me numrin në rritje të VEO-ve, veçanërisht të përsëritësve. Çfarë implikimesh sjell kjo për zgjedhjet e regjimeve dhe programet e ndërhyrjes? Numri në rritje nënkupton gjithashtu se do të ketë më shumë përvojë dhe praktika për t'u shkëmbyer, gjë e cila mundëson saktësimin e rekomandimeve të paraqitura në këtë dokument.
- Roli i shërbimit të provës, duke marrë në konsideratë dënimet më të shkurtra dhe dënimet alternative.
- Roli i fesë në punën e përditshme me VEO-të, por edhe në programet e specializuara të daljes.

Ky dokument do të përditësohet në fund të vitit 2017 për të përfshirë pikëpamje të reja nga studimet dhe praktika.

Shtojcë

Referenca të përzgjedhura

- Beckford, James, Daniele Joy, and Farhad Khosrokhavar. *Muslims in Prison: Challenges and Change in Britain and France*. Basingstoke, England & New York: Palgrave MacMillan, 2005.
- Calverley, Adam. *Cultures of Desistance: Rehabilitation, Reintegration and Ethnic Minorities*. Taylor & Francis, 2012.
- Cottee, Simon. 'Reborn into Terrorism: Why Are So Many Isis Recruits Ex-Cons and Converts', *The Atlantic*, 25 January 2016.
- Dean, Christopher. 'The Healthy Identity Intervention: The UK's Development of a Psychologically Informed Intervention to Address Extremist Offending' In *Prisons, Terrorism and Extremism: Critical Issues in Management, Radicalisation and Reform*, edited by Andrew Silke, 89-107. London: Routledge, 2014.
- Europol. "European Union Terrorism Situation and Trend Report (Te-Sat)", The Hague: European Union, 2016.
- . "European Union Terrorism Situation and Trend Report (Te-Sat)", The Hague: European Union, 2014.
- Farrall, Stephen. *Understanding Desistance from Crime: Emerging Theoretical Directions in Resettlement and Rehabilitation*. Edited by Adam Calverley Maidenhead: Open University Press, 2006.
- Gilliat-Ray, Sophie, Stephen Pattison, and Mansur Ali. *Understanding Muslim Chaplaincy*. Surrey, UK: Ashgate, 2013.
- Global CounterTerrorism Forum. 'Prison Management Recommendations to Counter and Address Prison Radicalization', 2015.
- . 'Rome Memorandum on Good Practices for Rehabilitation and Reintegration of Violent Extremist Offenders', Rome, 2012.
- Hamm, Mark S. *The Spectacular Few: Prisoner Radicalization and the Evolving Terrorist Threat*. New York: New York University Press, 2013.
- King, Roy D., and Kathleen McDermott. "'My Geranium Is Subversive": Some Notes on the Management of Trouble in Prisons', *The British Journal of Sociology* 41, no. 4 (1990).
- King, Roy D., and Sandra L. Resodihardjo. 'To Max or Not to Max', *Punishment & Society* 12, no. 1 (2010): 65-84.
- Liebling, Alison. *Prisons and Their Moral Performance*. Oxford: Oxford University Press, 2005.
- . *Suicides in Prison*. London: Routledge, 2002.
- Liebling, Alison, Ruth Armstrong, Ryan J. Williams, and Richard Bramwell. 'Locating Trust in a Climate of Fear: Religion, Moral Status, Prisoner Leadership, and Risk in Maximum Security Prisons — Key Findings from an Innovative Study', *Prisons Research Centre, Institute of Criminology: University of Cambridge*, 2015.
- Liebling, Alison, and Helen Arnold. 'Social Relationships between Prisoners in a Maximum Security Prison Violence Faith and the Declining Nature of Trust', *Journal of Criminal Justice* 40 (2012): 413-24.
- Liebling, Alison, Helen Arnold, and Christina Straub. 'An Exploration of Staff-Prisoner Relationships at Hmp Whitemoor: 12 Years On.', Cambridge: Cambridge Institute of Criminology, Prisons research centre, 2011.

- Liebling, Alison, and Ryan J. Williams. 'The New Subversive Geranium: Some Notes on the Management of Additional Troubles in Maximum Security Prisons', *British Journal of Sociology* (in press).
- Lloyd, Monica, and Chris Dean. 'The Development of Structured Guidelines for Assessing Risk in Extremist Offenders', *Journal of Threat Assessment and Management* 2, no. 1 (2015): 40-52.
- Network, Radicalisation Awareness. 'Ex Post Paper Ran Exit', edited by RAN P&P. Amsterdam, 2016.
- Network, Radicalization Awareness. 'Dealing with Radicalisation in a Prison and Probation Context Ran P&P — Practitioners Working Paper', (2015).
- Pressman, D. Elaine, and John Flockton. 'Violent Extremist Risk Assessment: Issues and Applications of Teh Vera-2 in High-Security Correctional Setting', In *Prisons, Terrorism and Extremism: Critical Issues in Management, Radicalisation and Reform*, edited by Andrew Silke, 89-107. London: Routledge, 2014.
- Spalek, Basia. 'Radicalisation, De-Radicalisation and Counter-Radicalisation in Relation to Families: Key Challenges for Research, Policy and Practice', *Security Journal* 29, no. 1 (2016// 2016): 39-52.
- Spalek, Basia, and Lynn Davies. 'Mentoring in Relation to Violent Extremism: A Study of Role, Purpose, and Outcomes', *Studies in Conflict & Terrorism* 35, no. 5 (2012): 354-68.
- Kombet e Bashkuara. "Manuali për menaxhimin e të burgosurve për vepra të ekstremizmit të dhunshëm dhe parandalimin e radikalizimit të dhunës në burgje", Nju-Jork: Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogën dhe Krimin, tetor 2016.
- Ward, Tony, and Shadd Maruna. *Rehabilitation*. Taylor & Francis, 2007.
- Williams, Ryan J., and Alison Liebling. "Faith Provision, Institutional Power and Meaning among Muslim Prisoners in Two English High Security Prisons", In *Religion in Prison*, edited by Kent Kerley: Praeger, in press.

Translated within:

